

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7744 E enjte 20 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Pas gostisë evropiane (19.12) presidentët e dy vendeve ballkanike komentuan letrat dërguar atyre nga presidenti i SHBA-së Donald Trump. Thaçi dhe Vuçiç ...
Vijon në faqen 20

Nga VIRTUTY GACAFFERI
Thaçi e Vuçiç në Bruksel - Zgjidhje e afërt Kosovë-Serbi?


Opinion Ditës
Një parodi e madhe po ndodh. Ndërkohë që studentët, gjithnjë e më të shumtë në numër, po i braktisin sallat e Ramës, PD dhe LSI kanë vendosur t'i japin ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Luli dhe Monika si freshistë të devotshëm




Arsyeja: Cënim i sigurisë kombëtare
Edi Rama dëbon nga vendi ambasadorin e Iranit. Xhon Bolton: Bashkë kundër terrorit

Krahu i djathtë i Trump dhe sekretari Pompeo: Me Ramën dhe Shqipërinë kundër terrorizmit
Kryeministri Edi Rama ka shpallur non-grata ambasadorin e Iranit në Shqipëri dhe e ka dëbuar nga vendi bashkë me një diplomat tjetër, me argumentin se përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare. Ky veprim është mbështetur nga krahu i djathtë i presidentit Trump, këshilltari për sigurinë kombëtare i SHBA, Xhon Bolton...

Në faqen 15

QEVERIA AKORDON "PAKETEN E SOLIDARITETIT", 3 MILIONE EURO PER FESTAT SHPERBLIMET E FESTAVE, JA KATEGORITE QE PERFITOJNE

Fondi do të shpërndahet për familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar e të verbërit. Qeveria: Gjithsej 130 mijë përfitues



(Në foto) Një studente paraplegjike, në llozhen e parlamentit, gjate një seance plenare

MINISTRI I FINANCAVE
Ahmetaj: 19 milionë euro, hera e parë që po investohet në konvikte në 28 vite

Në faqen 9

DEMSHPERBLIMI
66 milionë lekë të rinj kalojnë në llogaritë e ish-të përmdjekurve politike

Në faqen 8

ALEANCA PD-LSI
Opozita thyen sot bojkotin në Kuvend: Mbështesim protestën e madhe të studentëve

Në faqen 4

INCIDENT NE GJUETI
Elbasan, plumb pas koke punonjësit të Pyjores. Policia: Autori i dehur, ishte aksident

Në faqen 6

TIRANE
Lista paraprake, emrat e fituesve që përfitojnë kredi të butë nga bashkia
Në faqen 10-11

Rebelohen të rinjtë: Po vrisni shpresën. Kreu i qeverisë: Pakt për "8 pikat"

Rama në Vlorë, përplasje e fortë me studentët

Kryeministri pritet me protestë në universitet: Përgjysmim tarifash

Kryeministri Edi Rama vijoi dje turin e tij të dialogut me studentët. Kësaj here ai zgjodhi të bashkëbisedoi me studentët e Universitetit "Ismail Qemali", të cilët, gjithashtu, mbështesin protestën e bashkëmoshatarëve tyre në Tiranë. Takimi ka nisur i tensionuar, pasi një



grup i madh studentësh nuk e kanë pritur mirë praninë e kryeministrit në këtë takim, ndërsa janë ulur në hyrje të universitetit. Madje disa prej tyre deklaruan se ata nuk ishin lajmëruar nga rektori se i pranishëm në këtë takim do të ishte edhe ...

Në faqen 2



Ekzekutivi ka publikuar përgjigjet për 7 nga 8 kërkesat e paraqitura nga studentët

Qeveria ofron zgjidhje, pika që mban peng dialogun me studentët

Nuk plotësohet vetëm kërkesa për peshën e votës

Qeveria dhe studentët po shkojnë drejt një zgjidhjes së konfliktit të tyre, çka pritet t'i japë fund dhe ngërçit të krijuar. Pas insistimit të studentëve për të mos dialoguar me kryeministrin pa plotësuar më parë 8 kërkesat e tyre, qeveria ka ofruar zgjidhjen e saj konkrete për 7 nga 8 kërkesat e paraqitura nga studentët. Përjashtim bën vetëm kërkesa për balancimin e fuqisë së votës mes studentëve dhe stafit akademik në zgjedhjen e trupës drejtuese të fakulteteve dhe universiteteve. Ashtu siç edhe paralajmëroi dje nga Vlora, në portalin Shqipëria që duam, është publikuar pakti i propozuar nga kryeministri, por që pret dialogun e studentëve.

Siç bëhet e ditur në këtë faqe kryeministri angazhoi disa grupe pune, të cilat punojnë për dokumentin e një pakti për universitetin. Përtej përgjigjes konkrete për 8 pikat e dala nga protesta studentore, qeveria thekson se ky pakti për Universitetin do të jetë një dokument angazhimesh për të adresuar probleme të përgjithshme për universitetin, si edhe probleme specifike për çdo universitet - bazuar në informacionet, opinionet, idetë e sugjerimet e mblidhura gjatë procesit të saponisur të dialogut. Kjo faqe u krijua enkas për t'i shërbyer këtij procesi dhe është në dispozicion të kujtdo që dëshiron të kontribuojë me idetë e veta. Grupet e punës kanë hartuar një draft paraprak të këtij pakti, i cili është i hapur tashmë për t'u dialoguar dhe përmirësuar nga çdo individ që kërkon të japë kontributin në të. Duke i marrë pikat me radhë, qeveria është e gatshme që brenda janarit të vitit të ardhshëm të plotësojë një nga pikat kryesore, atë për ulen e tarifave të studimit. Për këtë pikë qeveria propozon një tarifë të përkallëzuar, ku për studentët me mesatare 9 deri në 10, për studentët nga familje në ndihmë ekonomike, si edhe për të verbërit dhe studentët paraplegjikë e tetraplegjikë, kjo tarifë do jetë zero. Për kategoritë e tjera do ketë përkallëzime të tarifës në bazë të mesatares së studentit. Për nxënësit me mesatare më të vogël se 6 do ketë përgjysim të tarifës për



SHKURTE

Ndryshon strategjia/ jo bllokim rrugësh, sot protesta para Kuvendit

Me një numër të reduktuar ndjeshëm, studentët kanë vijuar edhe gjatë ditës së djeshme protestën e tyre para Kryeministrit. Ata marshuan nga fakultetet e tyre drejt Kryeministrit, duke kërkuar me këmbëngulje të plotësohen kërkesat e tyre dhe jo negociata me kryeministrin. "Nuk jam për negociata, sepse kemi kërkuar dialog më parë për sa i përket arsimit me ministrin dhe nuk na ka dëgjuar. Tani le ta gjejë mënyrën dhe të mbajë përgjegjësinë e kohës së humbur", tha një student. "Duke marrë shkas edhe nga vizitat e kryeministrit nëpër universitete, mendoj që dialogu nuk është i frytshëm. Ndaj vazhdimi i protestës është mënyra më e mirë", tha një tjetër student. Ndërkohë, të enjten studentët paralajmërojnë se rrugëtimi i protestës do të përqendrohet përpara Kuvendit. Ndërkohë që ata duket se kanë hequr dorë nga taktika e bllokimit të rrugëve, pasi kjo dëmton qytetarët. "Bllokimi i rrugëve është diçka që na dëmton neve dhe qytetarët, pasi ne i kemi mbështetur qytetarët, por që ishte një zgjidhje e përkohshme deri në momentin që kryeministri të kuptojë që ne do të vazhdojmë protestën", tha një student tjetër.

Nga udhëtimet me avion te strehimi, ja çfarë ofron karta e studentit

Paralelisht me publikimin e draftit të paktit për uni-versitet, qeveria ka punuar edhe për hartimin e projektvendimit të parë që ka të bëjë me kartën e studentit. Sipas këtij projektvendimi të propozuar nga Ministria e Arsimit, të gjithë studentët në universitetet e Shqipërisë do të pajisen me kartën e posaçme të studentit, përmes së cilës mund të përfitojnë një sërë lehtësirash financiare. Kështu, studentët mund të përfitojnë strehim social, kurim falas nëpër spitale, si dhe do të kenë të paguara sigurimet shëndetësore. Për studentët që janë prindër do të ofrohet regjistrim në çerdhe apo kopshte me tarifa të reduktuara për fëmijët. Po kështu, të gjithë ata që ndjekin arsimin e lartë do të përfitojnë transport publik me lehtësi, përfshirë dhe atë ajror, hyrje falas në biblioteka, teatër dhe muze, si dhe kualifikime falas për qëllime punësimi. Karta e studentit do të lëshohet nga Qendra e Shërbimit Arsimit, një institucion i posaçëm që pritet të ngrihet shumë shpejt. Qeveria nuk ka përcaktuar në vendim se, cilat shërbime do të jenë falas për studentët dhe cilat me tarifë të reduktuar.

PAKTI PËR UNIVERSITETIN

- PIKA 1**
 - > Tarifat të paguhen nga qeveria nga 100% deri në 50% me shkallëzim.
 - > 100% për studentët me mesatare 9 deri në 10, për studentët nga familje në ndihmë ekonomike, si edhe për të verbërit dhe studentët paraplegjikë e tetraplegjikë. Këto dy kategori mund të kenë edhe një bursë prej 100 USD.
 - > 75% për studentët me mesatare 8 deri në 9
 - > 50% për studentët me mesatare 6 deri në 8 (50% po ashtu me mesatare më të ulët se sa 6, por deri në fundviti akademik 2019-2020. Kjo bëhet për një mundësi të barabartë në një start të ri dhe për këtë arsye asnjë student, pavarësisht mesatares, nuk do të paguhet më shumë se sa 50% të tarifës deri në vitin e ardhshëm akademik). Skema e shkallëzimit meritokratik është ende në diskutim dhe të gjithë janë të ftuar të kontribuojnë me mendimin e tyre
 - Afati i zbatimit: janar 2019
- PIKA 2**
 - > Të krijohet një faqe online, ku të publikohen të gjitha buxhetet dhe shpenzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe çdo IAL-i publik. Faqja të shërbejë edhe si një platformë, për ekspozimin e akteve të korrupsionit apo të shkeljeve të çdo lloji në universitet.
 - Afati i zbatimit: janar 2019
- PIKA 3**
 - > Çdokush që ka njohuri për një praktikë ndërkombëtare, ku peshën e votës së studentëve në zgjedhjet në universitet është siç kërkohet në këtë pikë, është i lutur ta bëjë publike. Maksimalisht po punohet për ta adresuar këtë pikë, duke parë me detaje çështjen e përfaqësimit të studentëve në vendimarrje, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.
 - Afati i vendimit: janar 2019
- PIKA 4**
 - > Transparenca e titujve shkencorë është aktualisht një detyrim ligjor i Universitetit. Sidoqoftë po punohet për një propozim konkret si më poshtë, që meriton të diskutohet.
 - Biblioteka Kombëtare të ngrejë një portal të unifikuar, ku të hidhen të gjitha doktoraturat. Të digitalizohen doktoraturat që janë në letër (hardcopy). Kontrolli antiplagjiaturë i tyre të kryhet nëpërmjet një software-i të posaçëm dhe të gjitha rastet e dyshuara ti kthehen Komisioneve të Posaçme Universitare për rivlerësim.
 - Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë nga ana e saj, të nisë verifikimin e kriterëve të ligjshmërisë për titujt akademikë.
 - Afati i fillimit të zbatimit: mars 2019
- PIKA 5**
 - > Qeveria të shkarkojë të gjithë anëtarët e bordeve të emëruar nga MASR. Anëtarët e rinj të emërohen nëpërmjet një procesi të hapur, ku figura publike dhe ekspertë me profil të lartë, të zgjidhen rojtare të interesit publik në administrimin e universiteteve. Po hulumtohen praktikat më të mira ndërkombëtare për të parë mundësinë që njëri prej anëtarëve të vijë nga trupa studentore.
 - Afati i zbatimit: shkurt 2019
- PIKA 6**
 - > Marrëveshja e nënshkruar në nëntor me Qendrën e Shërbimeve Arsimore Franceze, për ta bërë kartën tonë pjesë të European Student Card (ESC) është një bazë shumë e mirë për finalizimin e këtij procesi
 - Të miratohet VKM me shërbimet që do të ofrohen me çmim të reduktuar për studentët. Të fillojë procesi i pajisjes me Kartën e Studentit dhe të pajisen të gjithë studentët.
 - Afati i zbatimit: Shtator 2019
- PIKA 7**
 - > Të përfundojë procesi i blerjes dhe vënies në dispozicion të studentëve të Bibliotekës Universitare Digjitale. Të gjitha universitetet në vend do të kenë akses në bibliotekën elektronike universitare, si dhe në databazën kombëtare të doktoraturave.
 - Afati i zbatimit: mars 2019
- PIKA 8**
 - > Të nisë vlerësimi i performancës për çdo IAL në vend, ku elementët kyç do të jenë:
 - > Sondazhi kombëtar i studentëve për çdo pedagog, program mësimor, departament e fakultet;
 - > Vlerësimi i produktit kërkimor për çdo departament, fakultet dhe IAL;
 - > Vlerësimi i jashtëm i cilësisë, në përputhje me "Kodin e cilësisë së arsimit të lartë".
 - Afati i fillimit të zbatimit: mars 2019

këtë vit akademik, por vitin tjetër ata do duhet të dalin nga kjo mesatare për të përfitur sërish. Gjithashtu, pakti parashikon të krijohet një faqe online, ku të publikohen të gjitha buxhetet dhe shpenzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe çdo IAL-i publik. E vetmja pikë për të cilën qeveria nuk ofron një zgjidhje është ajo që mban numrin 3 në listën e kërkesave të studentëve dhe që ka të bëjë me peshën e votës në zgjedhjen e trupës drejtuese universitare. Për këtë qeveria fton studentët që kanë njohuri për një praktikë të tillë ndërkombëtare ta bëjnë publike. Ndërkohë që të gjitha kërkesat e tjera qeveria përpiqet që t'i japë një zgjidhje të saj dhe që kërkon ta diskutojë tani me studentët.

PROTESTAT SKENARI

Valentina Madani

Opozita bashkë me qytetarët do të nisë sot nga parlamenti rezistencën ndaj qeverisë. Kreu i opozitës, Lulzim Basha, nga Unaza e Re bëri dje thirrje që qytetarët të bashkohen me protestën e studenteve paraditen e sote para Kuvendit. Z.Basha akuzoi se shteti po funksionon me trafikantët e drogës, oligarkët dhe kupolën e Rilindjes, ndërsa po rrënohen qytetarët shqiptarë. Z.Basha ishte sërish dje në zonën e Unazës së Re për të shprehur protestën bashkë me banorët kundër projektit të Unazës së Madhe. Ai u bëri thirrje qytetarëve të dalin sot në protestë e t'iu bashkohen studentëve. Ai kërkoi nga qytetarët të mblidhen tek Kuvendi dhe nga sot të nisnin rezistencën. "Sot ju e kemi parë se si plani urbanistik i Tiranës është ndryshuar nga Veliq dhe është miratuar nga Edi Rama. Ndryshimi i këtij plani konsiston në ndryshimin rrjedhjes së Lumit të Lanës. Në fakt, është një bandë që nuk ka asnjë qëllim për vendin përveç grabitjes. Kjo është arsyeja pse këta njerëz janë në protestë. Shqipërimë e konsiderojnë thjesht dhe vetëm si një koloni ku grabisin gjithçka dhe deri në palcë qytetarët. Nuk është vetëm një çështje tarifash. Është çështja e një sistemi të ngritur nga Edi Rama, ku politikanë, kriminelë e pedagogët të korruptuar kanë në dorë fatin e 140 mijë të rinjve e qindra mijëra të tjerëve që do vijnë. Ata nuk mund të jenë peng i kësaj klিকে të korruptuar. Me gjithë këto të zeza që do kishin rrëzuar çdo qeveri europiane, sot dua të ndaj me shqiptarët dy lajme të mira. Nuk ka rrugë tjetër veç përbaljes. E patë si ishte katandisur sot Edi Rama në Vlorë. E ka kuptuar se askush nuk ia blen më gënjeshtat. Nuk e beson më askush. Kanë vendosur të mos negociojnë, sepse e kanë kuptuar se ky o do përpiqet t'i blejë negociatorët, ose do i mashtrtojë. 60 mln euro është afera Veliq-Bego. E kemi parë deklaratën e Lei Fenit? Planin urbanistik kush e ndryshoi. 200 familje të nxirren në rrugë që të pastroheshin 60 mln euro të drogës e krimi. Shteti ka rënë. Gjykata Kushtetuese ka rënë, prokuroria ka rënë. E vetmja rrugë është ajo e përbaljes. U bëj thirrje qytetarëve të bashkohen nesër me studentët masivisht para Kuvendit. Të nisim nga nesër rezistencën", deklaroi Basha. Kreu i PD-së u bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të protestojnë masivisht para Kuvendit në mënyrë që sipas tij, të mundet e keqja që ka pushtuar

Kreu i PD, tek "Astiri": Shteti po drejtohet nga trafikantët dhe oligarkët

Basha, thirrje qytetarëve: Të nisim rezistencën, të gjithë te Kuvendi

"Protestë kundër projektit klientelist të Ramës"



Kreu i PD-së Lulzim Basha me banorët e "Astirit"

DEKLARATA

"Ndryshimi i planit urbanistik konsiston në ndryshimin e rrjedhës së lumit Lana, me qëllim që të prishen banesat e qytetarëve dhe të shpëtojë Edmond Bego. Ai ka në plan të ndërtojë 30 mijë metra katrorë apartamente. Janë të përfshirë Arben Ahmetaj, Damian Gjiknuri, Erion Veliq, Edi Rama, Taulant Balla dhe kompania fantazmë", - tha z.Basha.

PD: 4 PYETJE QË DUHET T'U JAPË PËR GJIGJE EDI RAMA DHE ERION VELIJAJ

Edi Rama detyroi sot (dje) Erion Veliqin dhe Arben Ahmetajn të bëhen qesharakë në sytë e shqiptarëve. Duke bërë sikur nuk kuptojnë për çfarë kanë firmosur, ata synojnë të mbulojnë skandalin tjetër në zonën pranë Unazës së Re. E vërteta, e bazuar në dokumente është se Edi Rama dhe Erion Veliq kanë ndryshuar Planin Urbanistik të Tiranës, në mënyrë që Lumi i Lanës të mos prekë tokën ku Edmond Bego do të investojë 60 milionë euro para të pista. E vërteta është se privatizimi i zonës së ish-Serave është bërë me firmën e Arben Ahmetajt. Edi Rama dhe Erion Veliq duhet t'u thonë shqiptarëve:

- Pse u ndryshua Planin Urbanistik i Tiranës dhe pse u devijua Lumi i Lanës në zonën ku planifikon të ndërtojë Edmond Bego?
- A ka aplikuar Edmond Bego për leje ndërtimi me projektin e hartuar nga kompania italiane MISALAB?
- A ka regjistruar në hipotekë Edmond Bego pronat për efekt të ndërtimit të pallateve?
- A do të prishen banesat e 200 familjeve për t'i hapur rrugë ndërtimit të pallateve nga Edmond Bego?



Deputetja Jorida Tabaku dhe eksperti ligjor i PD-së, Gazmend Bardhi

PD kundër Ibrahimit në krye të KLP:

Rama synon kontrollin e SPAK-ut

Gent Ibrahim, ekspert i për reformën në drejtësi, fitoi dje besimin e kolegëve dhe mori në duar drejtimin e institucionit që konsiderohet si qeveria e prokurorëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Për Partinë Demokratike, emërimi i Gent Ibrahimit në krye të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është prova e kapinges politikë të organit të ri të qeverisjes së prokurorisë. Në një deklaratë për mediat, selia blu thotë se eksperti i qeverisë për reformën në drejtësi dhe kunati i ish-ministres Kodheli nuk duhet ta kishite fare vendin në KLP. "Gent Ibrahim është aty si investimi politik i Edi Ramës për të kontrolluar sistemin e drejtësisë. PD ka denoncuar kohë më parë projektin e Edi Ramës për të emëruar kryetarët e dy organeve që qeverisin drejtësinë. Emërimi i sotëm provoi se shqetësimi i Partisë Demokratike ishte i drejtë". Sipas PD-së, Edi Rama nuk ka ndërmend të ndërtojë një drejtësi më të mirë për shqiptarët, por një drejtësi që i shërben atij, ministrave të tij të korruptuar dhe krimi të organeve me të cilin bashkëqeveris. "Me kapjen politike të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Edi Rama synon t'i shpëtojë drejtësisë, duke kontrolluar dhe penguar SPAK-un të bëjë atë që shqiptarët presin me padurim: burg për politikanët dhe zyrtarët e korruptuar e të lidhur me krimin", thuhet në reagimin e PD-së.

Deputetët do mbështesin protestën e studentëve

Rikthimi sot në Kuvend, zbardhet skenari i opozitës



gjithashtu që pasi paralel me punimet e Kuvendit, jashtë dyerve të tij është menduar edhe mbajtja e një proteste nga ana e qytetarëve, që ka gjetur mbështetjen e opozitës. Megjithatë, de-

JOZEFINA TOPALLI
"Lulzim Basha po kthehet në parlament vetëm për të siguruar mandatin e tij si deputet. Ai jo vetëm nuk djeg mandate, gjë që do kishte çuar në krizë automatike mazhorancën aktuale, por ai ëndërron të hyjë edhe një herë në qeveri me socialistët e Edi Ramës", shprehet ish-deputetja e PD-së.

putetët demokratë mohojnë që do të bashkohen me protestuesit. Debate të gjata pritet të këtë edhe në seancën e së premtes ku do të diskutohet propozimi i opozitës për vetingun në politikë. Me rik-

thimin në parlament, opozita njëherazi shpëton edhe mandatet e deputetëve të saj, që skadonin me mbushjen 6 muaj pa marrë pjesë në një seancë plenare. Mbledhja e grupit parlamentar të PD-së, vjen pas 5 muajsh ku opozita dhe grupi përfaqësues i Partisë Demokratike ka bojkotuar duke mos marrë pjesë në seancat plenare të zhvilluara në Kuvend, ndërsa pritet që ditën e nesërme, të marrë pjesë në seancën e së enjtes në parlament. Ndërkohë në seancën e ditës së nesërme, në parlament 3 orët për të folur i takojnë mazhorancës dhe 2 orët opozitës.

bashkohen masivisht para Kuvendit. E vetmja shpresë e kësaj bande është që të përçajë shqiptarët. Studentët na kanë dhënë një mësim të madh. Po të jemi bashkë, mund ta mposhtim të keqen. I ftoj të gjithë që nesër të jemi të gjithë para Kuvendit në një protestë të madhe për çlirimim e vendit nga errësira dhe nga kjo e



GAZMEND BARDHI

"Vendndodhja e këtij ndërtimi është përgjatë Unazës së Madhe, buzë lumit Lanë, sipas ndryshimit të bërë me firmën e Rama-Veliaj në vitin 2017. Projekti luksoz i Edmond Begos është krijuar nga një studio italiane, ku si klient paraqitet kompania tjetër e Edmond Begos, 'Inerte Ekspres', tha z.Bardhi.

Veliaj, Bashës: Liro ashensorin e pallatit

Akuzat e PD, Bashkia Tiranë: S'ka leje ndërtimi për Begon

Bashkia e Tiranës hodhi dje poshtë akuzat e PD-së se është ndryshuar plani urbanistik i Tiranës, për të favorizuar sikundër u shpreh PD-ja, pallatet e Edmond Begos. Sipas Bashkisë së Tiranës, nuk ka asnjë leje ndërtimi për Edmond Begon dhe sipas tyre, Lulzim Basha është i vetmi kryetar i bashkisë që firmosi leje për shtesë kati për veten. Bashkia e Tiranës i bën thirrje Bashës të lirojë ashensorin e pallatit ku banon, pasi sipas këtij institucioni ka zaptuar ilegalisht hapësirën e përbashkët që të ngjitet me ashensor personal. "Bashkia e Tiranës hedh poshtë akuzat qesharake të opozitës në këto ditë të vështira për Partinë Demokratike. Në zonën që përmend Lulzim Basha nuk ka asnjë leje ndërtimi të lëshuar nga Bashkia Tiranë. Plani i Përgjithshëm Vendor i çdo qyteti nuk përcakton gjurmët e rrugëve apo vijave ujore, por konceptet dhe drejtimet kryesore të këtyre zhvillimeve. Për përcaktimin e gjurmës së saktë të një rruge apo vije ujore duhet një analizë e mirëfilltë inxhinierike, e bazuar në rilevimin e terrenit të zonës si dhe në analiza shkencore hidroteknike", thuhet në deklaratën e bashkisë. Sipas saj: "Vetëm pas punës përgatitore inxhinierike mund të hartohet projekti teknik dhe projekti i zbatimit, që përcaktojnë me përpikmëri vendndodhjen e rrugës apo vijës ujore. Bashkia e Tiranës ka kontraktuar hartimin e projektit të kësaj rruge, projekti i hartuar nga inxhinierë, pasi ka kaluar dhe opionencë teknike, është miratuar si projekti teknik, i cili përcakton me saktësi gjurmën e rrugës, pavarësisht orientimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor. Është ky projekt që merr parasysh të gjithë analizën inxhinierike dhe hidroteknike të zonës, që përcakton saktësisht gjurmën e rrugës së vijës ujore".

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të II (dytë), për shitjen e pasurisë ULLUSHTE, me sip.3,400 m², Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 3271, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Selfer Stradi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **1,904,000 (në milion e nëntëqind e katër mijë) LEKË**.

Ankandi do të zhvillohet më datë **16.01.2019, ora 16:00**, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: gbyrth@hotmail.com

Unaza, denoncimi i PD-së: Shemben 200 banesa, si u ndryshua plani urbanistik

PD: Rama dhe Veliaj firmosën për rezidencën luksoze të Begos

"Projekti do të kushtojë 60 milionë euro"

Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje disa dokumente që sipas saj vërtetohet ndërtimi i ardhshëm i një projekti rezidencial luksoz nga trafikanti i drogës, Edmond Bego, me firmën e kryeministrit Edi Rama dhe kreut të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. PD akuzoi se Veliaj dhe Rama kanë ndryshuar planin urbanistik, por edhe rrjedhën e lumit të Lanës, për të favorizuar ndërtimin e një kompleksi rezidencial nga ndërtuesi Edmond Bego, i dënuar më parë për trafik droge. Përmes Jorida Tabakut e Gazment Bardhit, Partia Demokratike denoncoi ndryshimin e planit urbanistik të Tiranës, për të favorizuar sikundër u shprehën ata, pallatet e Edmond Begos. Tabaku tha se Rama dhe Veliaj nëpërmjet përcaktimit të 3 fitesve të tenderit dhe nëpërmjet falsifikimit ndërkombëtar të dokumenteve të njërit fites po përfitojnë 40 milionë dhe së fundmi, aferës korruptive të tyre i është shtuar edhe ndërtimi i projektit rezidencial luksoz të Begos, të cilin e cilëson edhe si mik të deputetit socialist Taulant Balla. Tabaku e Bardhi publikuan dokumentet për të vërtetuar denoncimet e projektit të Unazës së Madhe, ndërsa akuzuan kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj dhe kryeministrin Edi Rama se kanë favorizuar pronën 60 milionë euro të Edmond Begos, i njohur edhe si trafikant i drogës, duke devijuar projektin e Unazës së Madhe. "Edmond Bego ka parashikuar të ndërtojë një kompleks rezidencial luksoz tek zona e Unazës së Madhe. Për llogari të këtij projekti të trafikantit të drogës, Edi Rama dhe Erion Veliaj kanë ndryshuar planin urbanistik të Tiranës. Kanë ndryshuar rrjedhën e lumit Lanë në favor të projektit luksoz të trafikantit të drogës. Kanë planifikuar dëbimin nga shtëpitë të të paktën 200 famil-



Faksimilet e dokumenteve të publikuara dje nga PD

jeve për të mbajtur të paprekur pronën e Edmond Begos", theksozj.Tabaku. Në planin urbanistik të vitit 2013 projekti për sisteminin e Lanës prekte një pjesë të tokës, ku PD pretendon se do të ndërtohet kompleksi. Demokratët shprehën se me ndërhyrjen e kryeministrit, gjërat kanë ndryshuar: "Ndryshimi i projektit të Unazës së Madhe dhe sistemit të shtratit të lumit Lana për llog-

ari të Edmond Begos është kriminal. Nga ndryshimi i projektit preken rreth 200 familje, ku pjesa dërrmuese e tyre janë në proces legalizimi. Kjo do të thotë që Edi Rama do të nxjerrë në qiell të hapur mijëra banorë për t'i shërbyer pastrimit të parave të pista, që vijnë nga krimi i organizuar dhe trafiku ndërkombëtar i drogës", deklaroi z.Bardhi. Deputetja Jorida Tabaku i bëri thirrje prokurorisë të

JORIDA TABAKU
"Edmond Bego ka parashikuar të ndërtojë një kompleks rezidencial luksoz tek Unaza e Madhe. Për llogari të projektit të trafikantit të drogës, Rama dhe Veliaj kanë ndryshuar planin urbanistik të Tiranës. Kanë ndryshuar rrjedhën e lumit Lanë në favor të projektit luksoz të trafikantit të drogës. Kanë planifikuar dëbimin nga shtëpitë të të paktën 200 familjeve për të mbajtur të paprekur pronën e Begos", tha zj.Tabaku.

hetojë, ndërsa tha se këto janë dëshmi sesi paratë e drogës po pasrohen në ndërtim. "Kjo është një provë e qartë sesi në treg, në Tiranë, ndërtimi po përdoret për pastrimin e parave", tha zj.Tabaku. Sipas saj, projekti i ndërtimit të kompleksit rezidencial në Unazën e Re, në pronësi të biznesmenit Edmond Bego sipas PD do të kushtojë 60 milionë euro", deklaroi deputetja e PD-së.

PD fton banorët e Bregut të Lumit: Në protestë bashkë me studentët

Banorët e Bregut të Lumit në Tiranë protestuan sërisht dje për mungesën e dëmshpërblimeve nga ndërtimi i Bulevardit të Ri. Ata sulmuan ashpër kryeministrin e vendit si dhe kreun e Bashkisë së Tiranës për mungesën e dëmshpërblimit. Qytetarët e kësaj zone i drejtuan edhe opozitës, që nesër të ngrejë zërin në Kuvend për shqetësimin e tyre. "I bëjmë thirrje opozitës së bashkuar ta ngre zërin nesër (dje) në Kuvend. Me gjakun tonë ushqehet krimi", thanë banorët. Bashkë me banorët ishte edhe



deputeti i PD-së, Klevis Balliu, i cili iu bëri thirrje qytetarëve të bashkohen nesër në protestë të Kuvendit me studentët. "Iu bëj thirrje të gjithë qytetarëve që

nesër të bashkohen me studentët. Ftoj të bashkohen të majtë e të djathtë. Ky njeri është kthyer në një rrezik kombëtar. Bashkohuni dhe ta largojmë këtë kolerë që ka mbirë në vendin tonë. Po të njëjtin fat që kanë pasur regjimet e Shqipërisë, edhe ky të njëjtin fat do të ketë. Është koha që të vendosin qytetarët, koha e bandave ka marrë fund. Këtë nuk e them unë, por e thotë sovran. Të jeni nesër në orën 10 në Kuvend me protestën e studentëve, që kërkesat e tyre të plotësohen dhe zbatohen", tha Balliu.

DOMINUS
Njoftim Shitje ne Ankand
Shoqëria Përmbartimore "Dominus" Rruga "Sami frasheri"pili "Titan", kati trete Tiranë, cel 069205122
Shitje ne ankand e e dyte te pasurise:Tokë Arë, Nr.Pasurie 104/16, ZK 3774, vol 3, faqe 141, e ndodhur në Vilë-Ballaj, Kavajë
Çmimi me të cilin fillon shitja e pasurisë në ankandin e dyte është 1.323.000 lekë (një milion e treqind e njëzet e tre mijë)
Ankandi do të zhvillohet ne daten 25.12.2018, ora 16.00.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
PASURIA nr. 1/358, e llojit "Trrual dhe Ndërtëse" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Avionit) me sipërfaqe të truallit 273 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 200.2 m², Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, e regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 18, datë 07.01.2011 pranë Z.V.R.P.P.TIRANË, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.
ÇMIMI 36.389.985,28 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 02.01.2019.
CEL: 0684026666 ; 0693262866.

GREQI - Merr një tjetër rrjedhë vrasja e makabre e çiftit shqiptar në lagjen "Peristeri" të Athinës, në Greqi. Në 3 shkurt të vitit 2017, Thanas dhe Eleni Curra u ekzekutuan me nga një plumb në kokë në banesën e tyre. Ndërkaq, pasditën e djeshme, gjykata greke ka dhënë dënimet për 4 të arrestuarit për ngjarjen në fjalë. Vrasësit, një shtetas shqiptar dhe një grek u futën në banesën e Thanas dhe Eleni Curra duke hapur derën me një çelës kopje. Ata i qëlluan me plumb në kokë burrë e grua, ndërsa djalin e tyre autik e plagosën me thikë. Nga hetimet e prokurorisë, gjykata dënoi me 2 burgime të përjetshme Luan Hajdarin. E njëjta masë dënimi u dha

Ngjarja në 2017-ën, shoku i viktimës pagoi 60 mijë € vrasësit

Ekzekutimi i çiftit shqiptar Thanas dhe Eleni Curra, gjykata greke dënon katër autorët e krimit



dhe për shqiptarin vrasës, i njohur me pseudonimin Kili. Ky i fundit dyshohet se qëllon mbi Thanasin dhe Elenin.

Thoma Qirjaku, një shtetas grek që po ashtu mori pjesë në vrasje, u dënua me 15 vite burg. Edhe drejtuesi i taksisë

që çoi vrasësit në shtëpinë e çiftit shqiptar dhe i prit pas ekzekutimit u dënua me 15 vite burg. Ndërkohë, një tjetër shqiptar, Edmondi është në kërkim për këtë vrasje të dyfishtë dhe autoritetet greke kanë dyshime të forta se ai fshihet në Shqipëri. Sipas skedës së autoriteteve greke, Edmondi është njeri i rrezikshëm dhe i aftë të vrasë. "Gazeta Shqiptare" mëson ekskluzivisht se ngjarja nuk lidhet me një grabitje të mundshme, siç u fol



Çiftit shqiptar Thanas dhe Eleni Curra, i vrasë në Greqi

në fillim, por autorët kanë dashur t'i mbyllin gojën çiftit. Hetimet kanë zbuluar se 53-vjeçari Thanas Curra kishite miqësi me një nga të dënuarit dhe konkretisht Luan Hajdarin. Ky i fundit së bashku me një tjetër shqiptar, Edmondi (ka dhe disa emra të tjerë) merrreshin me gra-

bitje dhe trafik droge. Luan përdorte automjetin e punës të Thanasit për transport droge, deri sa ky i fundit e kuptoi. Disa ditë përpara se të vritej, 53-vjeçari foli me një efektive policie. Kjo lëvizje u kuptua nga Luan Hajdari dhe ai porositi vrasjen e çiftit, duke paguar 60 mijë euro.

Arrestohet 27-vjeçari Preni Zavalina. Policia: Ngjarja ndodhi aksidentalisht, autori në gjendje të dehur

Vritet me plumb pas koke punonjësi i Shërbimit Pyjor

37-vjeçari Ardi Boduri kishte dalë për gjah, e qëllloi miku i tij

ELBASAN

Një specialist i Shërbimit Pyjor në Elbasan është vrarë aksidentalisht teksa kishte dalë për gjah me shokët e tij. Bëhet fjalë për Ardi Bodurin, baba i dy fëmijëve, i cili u plagos rëndë me armë gjahu dhe më pas humbi jetën gjatë rrugës për në spital. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë Vendore të Elbasanit bënë me dije se ngjarja ndodhi në orët e vona të mbrëmjes së të martës në një zonë të pyllëzuar, në fshatin Shelcan. Menjëherë pas sinjalizimit për vrasjen e 37-vjeçarit, blutë kanë nisur hetimet. Nga kryerja e veprimeve paraprake hetimore ka rezultuar se gjithçka ka ndodhur aksidentalisht. Ndërkohë, ka përfun-



37-vjeçari i vrarë, Ardi Boduri

duar në pranga shoku i viktimës, Preni Zavalina.

VRASJA

Policia e Elbasanit ka zbuluar detaje të reja në lidhje me ngjarjen tragjike

që i mori jetën 37-vjeçarit Ardi Boduri. "Nga specialistët për hetimin e krimit në Drejtorinë e Policisë Elbasan u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit: Preni Zavalina, 27

vjeç, banues në fshatin Mlizë Elbasan. Arrestimi i tij u bë pasi rreth orës 23:00, në fshatin Shelcan, në një zonë të pyllëzuar është vrarë me armë gjahu shtetasi Ardi Boduri, 37 vjeç. Nga veprimet e para të kryera nga specialistët për hetimin e krimit në DVP Elbasan dhe ata të Komisarariatit të Policisë rezultoi se viktimja së bashku me autorin dhe tre persona të tjerë kishin lidhje fisnore dhe krushqie me njëri-tjetrit", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të blutë të Elbasanit. Ndërkaq, mësohet se pesë shokët, me një mjet tip fuoristradë e me targa AA721EF kanë dalë për gjueti dhe në momentin që ka gjuatjet gjuhun, autori duke qenë në errësirë dhe nën efektin e alkoolit

ka qëlluar 37-vjeçarin nga mbrapa në kokë. Po sipas policisë, viktimja ka qenë specialist i Pyjeve në Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe mjeti fuoristradë është në pronësi të kësaj agjencie. Gjithashtu, blutë sqaruan se Ardi Boduri ka pasur autorizim dhe ka shkruar për vrasjen dhe marrjen e mostrave nga dhelpira e kuqe për shkak të sëmundjes së tërbimit, projekt i autorizuar nga Ministria e Bujqësisë. Grupi hetimor ka sekuestruar dy armë gjahu dhe po vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Në Komisarariatin e Policisë Elbasan janë shoqëruar edhe tre persona të tjerë, për veprime të mëtejshme procedurale.

SHKURT

Shembet galeria, humb jetën minatori 58-vjeçar

POGRADEC - Një minator ka humbur jetën pasditën e djeshme në minierën e kromit në fshatin Pojskë të Pogradecit. Bëhet fjalë për 58-vjeçarin Vasfi Demo, banues në fshatin Rrëmenj. Mësohet se ai ka qenë duke nxjerrë krom në njërin prej galerive, kur një masiv shkëmbor ka rrëshqitur dhe e ka zënë poshtë. Menjëherë në vendngjarje ka shkruar policia, e cila ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.

Digjet makina, dyshohet zjarrvënie e qëllimshme

GJIROKASTER - Mëngjesin e djeshëm një automjet është përfshirë nga flakët në Gjirokastrë. Ngjarja ndodhi rreth orës 06:00, në lagjen "Mecitë". Mësohet se makina tip "Citroen" me targa AA650RV është shkruar plotësisht, pavarësisht ndërhyrjes së forcave zjarrfikëse. Sipas policisë, automjeti është në pronësi të Donjeta Xhelilit dhe nga hetimet paraprake dyshohet për zjarrvënie të qëllimshme. Megjithatë, ende nuk dihet shkaku i vërtetë i rënies së zjarrit, ndërsa policia ka nisur hetimet për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes.

Mësuesja vdes në aksident, KSSH: Kambanë alarmi për arsimin!

KORÇË - Luiza Dule, me profesion mësuese dhe humbi jetën në një aksident automobilistik në aksin rrugor Miras-Arrëz. Sipas policisë, 48-vjeçarja po udhëtonte së bashku me 6 persona të tjerë (mësues dhe infermierë), kur automjeti është batur në rrugë. "Më datë 19.12.2018, rreth orës 09:30, jemi njoftuar se në aksin rrugor Miras-Arrëz, ka ndodhur një aksident ku mjeti tip "Range-Rover" me targë AA 112 CA, me drejtues shtetasin Ç.H., banues në Miras, është batur në rrugë dhe për pasojë, ka humbur jetën një pasagjere në mjet, shtetasja L.D, 48 vjeçe, banuese në Miras. Drejtuesi i mjetit si edhe pasagjerët e tjerë ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e rrethanave të aksidentit", njoftoi policia. Pas vdekjes së mësueses Luiza Dule, ka reaguar edhe Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë. KSSH shkruan se vdekja e saj është një kambanë alarmi për të gjithë arsimin shqiptar, ndërsa shton se shpeshherë ka denoncuar problemet e transportit të nxënësve dhe mësuesve në zona të thella të vendit.

Fondacioni "Islamic Relief Worldwide" e ka zanafillën në Shqipëri në vitin 1991. Islamic Relief- Albania office është regjistruar si një organizatë ndërkombëtare në Shqipëri me vendim gjykatë nr. 44 me 14 Korrik 1994. Aktualisht Fondacioni operon në rrethet Shkodër, Tiranë, Korçë, Pogradecit, Lushnjës etj me projekte të ndryshme zhvillimore në sektorët e edukimit, infrastrukturës, rritjes së kapaciteteve, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, shëndetësisë dhe në projekte sezonale si Kurban, Projekti Dimerit dhe Ramazani.

FTESË PËR OFERTË

Tirana më 20.12.2018

Fondacioni Islamic Relief- Albania Office ka hapur ftesën për ofertë me objekt:

Marrje nenkontraktor për ndërtimin e 2 Ambulancave tipi A1, në prefekturën e Lushnjës, 1 në fshatin Cukaj i Vjeter dhe 1 në fshatin Hajdaraj;

Shenim: Oferta financiare, e cila duhet të perpilohet sipas specifikimeve teknike që ka ndërtimi objektiv.

Oferta juaj duhet të jetë në një zarf të mbyllur dhe të vulosur dhe duhet dërguar në adresën:

Adresa: Laprake, rruga e Durrësit, Blloku Gintash, pall E, kati i II, ap 8, Tirana ose mund ta dergoni në posten elektronike: info@islamicrelief.al

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është më datën **12.01.2019**

Për çdo pyetje ju lutem mos hezitoni të kontaktoni ne:
Tel. : +355 42413990,
Cel. : +355 676007676

Kreu i 'Kompensimit' ndryshoi pronën nga tokë arë e shkurre, në truall

Shpërdoroi detyrën, KLSH kallëzon në prokurori ish-nëndrejtorin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave

"Ka bërë kompensime financiare jo sipas zërit kadastral që prona ka pasur në kohën e shpronësimit"

TIRANË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kallëzuar në prokurori ish-nëndrejtorin e përgjithshëm dhe ish-drejtorin e Kompensimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave të Tiranës, i cili ka ushtruar postet në vitet 2014-2017. Në raportin KLSH-së thuhet se tjerash se: "Ka ndryshuar gjendjen e llojit të pronës nga tokë arë, shkurre, tokë pa fryt në truall, duke ndryshuar vlerën e kompensimit në dëm të shtetit, si pasojë e moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim me efekte financiare negative në fondin e kompensimit të ish-pronarëve në vlerën 736,006 mijë lekë.

NJOFTIMI I KLSH-SË:
"Ka marrë vendime për kompensim financiar në mungesë të vendimeve të ish-KKKP dokumentacionit të kërkuar ligjor dhe të parregullt, ka bërë kompensime financiare jo sipas zërit kadastral që prona ka pasur në kohën e shpronësimit. Ka ndryshuar gjendjen e llojit të pronës nga tokë arë, shkurre, tokë pa fryt në truall, duke ndryshuar vlerën e kompensimit në dëm të shtetit, si pasojë e moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim me efekte financiare negative në fondin e kompensimit të ish-pronarëve në vlerën 736,006 mijë lekë.

Ka kompensuar fizikisht më tepër me sipërfaqen totale prej 145735.6m² (14.57 ha) arë, ka bërë rivlerësim të vendimeve administrative të formës së prerë në kundërshtim me vendimit nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe qëndrimin të Komisionit të Venecias nr.861/2016, CDL-AD (2016) 023.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr.724/2, datë 21.06.2018 të miratuar nga Kryetari, ka audituar Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), Tiranë, për periudhën korrik 2016 deri në prill 2018. Bazuar në vendimin nr.190, datë 14.12.2018 të Kryetarit për shkelje të dispozitave ligjore të konstatuara, KLSH ka përcjellë për kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për konsumim të elementëve të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", neni 248 i Kodit Penal, për ish-nëndrejtorin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Kompensimit në ATP, sepse:

Në 1 rast (Vendim nr.163, datë 01.12.2016) u konstatua se: si pasojë e moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim, subjektet e shpronësuara janë kompensuar fizikisht më tepër me sipërfaqen totale prej 71408m² (7.14 ha) arë.

Në 2 raste u konstatua se ka marrë vendime për kompensim financiar në vlerën 94,762,840 lekë dhe kompensim fizik me sipërfaqen 45227.5m² arë, mbi bazën e një shkresë pa vullë, që i referohet vendimit të pretenduar. Këto shkresa nuk kanë emërtimin vendim nuk kanë nr. dhe as datën e vendimit të pretenduar, nuk dihet se cilët kanë qenë anëtarët e KKKP të cilët kanë marrë vendimin, si dhe mungon pjesa arsy-



etuese. Pra, nuk kemi të bëjmë me vendim të KKKP sepse nuk kanë elementët e formës dhe përmbajtjes së vendimit, e mbi të gjitha i mungon vula si mjet identifikues dhe ligjërues i vendimeve të marra nga ish-KKKP dhe pjesa arsyetuese.

Për pasojë, vendimet për kompensim financiar të bërë nga ATP në mungesë të vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, pra dokumentit ligjor mbi të cilin ATP mundet të japë vendim për kompensimin financiar dhe vlera prej 94,762,840 lekë do të konsiderohet si efekt financiar negativ në fondin e kompensimit të ish-pronarëve. Këto veprime janë

në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave".

Në 10 raste u konstatua se ka bërë përllogaritje të kompensimit të subjekteve të shpronësuara në vlerën totale prej 350,189,095 lekë mbi bazën e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të bëra për zërin kadastral "Truall", dhe jo sipas zërit kadastral që prona ka pasur në kohën e shpronësimit. ATP nuk ka vlerësuar financiar-

AKUZA

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr.724/2, datë 21.06.2018 të miratuar nga kryetari, ka audituar Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), Tiranë, për periudhën korrik 2016 deri në prill 2018. Bazuar në vendimin nr.190, datë 14.12.2018 të kryetarit për shkelje të dispozitave ligjore të konstatuara, KLSH ka përcjellë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për konsumim të elementëve të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" për ish-nëndrejtorin e përgjithshëm dhe drejtorin 'Kompensimit' në ATP.

isht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit, duke shmangur procedurën e rregullt ligjore për identifikimin e llojit të pasurisë në kohën e shpronësimit (mund të ketë qenë tokë bujqësore, pyll, kullotë etj.) Vendimet për kompensim janë marrë në mungesë të dokumentit të shpronësimit për sipërfaqet e kompensuara mbi bazën e të cilit do të përcaktohej koha e shpronësimit, si dhe zëri kadastral i pronës në kohën e shpronësimit.

Në rastet kur ATP në pamundësi për të verifikuar kohën e saktë të shpronësimit me pat të drejtë, i është referuar hartës së viteve 1937-1938, nga verifikimi i së cilës, realisht ka qenë i pamundur përcaktimi i zërit kadastral. Këto veprime janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" dhe pikën 3, ger-

ma a dhe d të VKM Nr.223, datë 23.3.2016 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave".

Në 2 raste u konstatua se, si pasojë e moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim, subjektet e shpronësuara janë kompensuar fizikisht më tepër me sipërfaqen totale prej 145735.6m² (14.57 ha) arë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i ndryshuar dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave", i ndryshuar.

Në 9 raste, për shumën 283,626,509 lekë, sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar, konstatohet se nga verifikimi i hartës dixhitale, pronat, për të cilat është bërë kompensimi, ndodhen jashtë vijave kufizuese (vijë e verdhë) të hartës e cila është marrë si referencë për kohën e shpronësimit.

Vlera prej 283,626,509 lekë, përfaqëson diferencën ndërmjet vlerës së llogaritur për kompensim financiar e fizik të sipërfaqes "Truall" dhe vlerës që duhet llogaritur sipas çmimit minimal të tokës dhe tokës "Arë", rrjedhimisht nuk është zbatuar procedura e saktë e llogaritjes sipas pikës 3, germa "d" të VKM nr.223, datë 23.3.2016.

Ka bërë rivlerësim të vendimeve administrative të formës së prerë të cilët kanë vendosur kompensimin financiar, duke rritur vlerën e kompensimit me 7,428,000 lekë për shkak të çmimit më të lartë të truallit për m² në disa Zona Kadastrale. Ky veprim bie në kundërshtim të vendimit nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese ku citohet "Gjykata Kushtetuese, lidhur me dispozitat

që parashikojnë që vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënie dhe një mase të caktuar kompensimi, vlerëson se ato ngrenë çështjen e "pritsshmërisë legjitime", por sipas ligjit nuk do t'i nënshtrohen rivlerësimit." dhe qëndrimin të Komisionit të Venecias nr.861/2016, CDL-AD (2016) 023, i cili shprehet "Vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënie dhe një mase të caktuar kompensimi... nuk do t'i nënshtrohen rivlerësimit sipas ligjit nr.133/2015."

Nuk ka vepruar lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të ATP Tiranë me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave, për objektet të cilave u është njohur e drejta e parablerjes, nëse janë privatizuar apo jo.

Nuk ka kërkuar informacion nga ZVRPP-të përkatëse, DAMT-të e Këshillave të Qarqeve apo organet e tjera përkatëse të Njësive të vetëqeverisjes vendore, nëse trashëgimtarët e subjekteve të shpronësuar kanë të regjistruar apo kanë përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". Gjithashtu nuk është kërkuar informacion dhe nuk ka ndonjë vërtetim nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore përkatëse, nëse në lidhje me çështjen ka apo jo ndonjë vendim të formës së prerë apo është në proces gjyqësor për pronën e përfituar me vendim të ish-KKKP-ve përkatëse. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 36 të ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i ndryshuar.

Janë 145 dosje për të cilat janë dërguar shkresat për "Plotësim dokumentacioni" subjektive përkatëse, dhe të cilave u kanë kaluar afatet ligjore të paraqitjes së dokumentacionit plotëues teknik-ligjor nga subjektet.

Për z. O.R.R. me detyrë ish-nëndrejtorin e Përgjithshëm dhe ish-Drejtorin e Kompensimit, i cili në mospërmbyshje të detyrës së tij funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, ka konsumuar elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, KLSH ka përcjellë me shkresë nr.327/15 prot., datë 06.10.2018 indicie për kallëzim penal Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: INVITATION TO BID
"RECONSTRUCTION OF KINDERGARTEN IN GUERRILE QUARTER, SHKODER CITY"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked **INVITATION TO BID "RECONSTRUCTION OF KINDERGARTEN IN GUERRILE QUARTER, SHKODER CITY"** to the address below.

For more details please refer to the link below:
http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=52278

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 11 January 2019, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:
United Nations Development Programme Albania
Str. "Skënderbeu", Gurten Center, 2nd floor,
Tirana, Albania
Fax: No. + (355) 4 225 02 86
E-mail: procurement.al@undp.org

Përfitues, ish-të dënuarit ose trashëgimtarët që i kanë plotësuar dosjet në kohë

Ministria e Financave: 66 mln lekë për ish-të përndjekurit

Kushti për të marrë dëmshpërblimin, fondi kalon përmes Thesarit të Shtetit

Buxheti i shtetit përmes thesarit ka kaluar në llogaritë e ish-të përndjekurve politikë 66 506 625 lekë.

Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion dhe sipas radhës së caktimit të dëmshpërblimit, fondet do të ndahen në mënyrë proporcionale për të gjithë ish-të dënuarit dhe familjarët e viktimave të pushtuara, me kusht që vlera e dëmshpërblimit gjatë fazës së parë të mos jetë më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

Sipas ligjit në fuqi, përfiton dëmshpërblim i dënuari ose familjarët e viktimave të dënuara, të ekzekutuara apo të pushtuara. Për të përfitur dëmshpërblim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) të jetë dënuar me dënim kapital, heqje lirie, internim dhe dëbim apo të jetë izoluar në hetuesi ose në një institucion mjekësor psikiatrik, për shkak të një vendimi gjykatës të formës së prerë, të një akti administrativ apo të urdhrave të hetuesisë, të dhëna gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991;

b) heqja e lirisë, izolimi në hetuesi apo në një institucion mjekësor psikiatrik, me vendim gjyqësor të formës së prerë apo me urdhrë të hetuesisë, të jetë për shkak të një veprë penale politike, siç përcaktohet në nenin 5 të këtij ligji; c) të ketë kryer ose të ketë vuajtur dënim penal të padrejtë të plotësisht ose pjesërisht; d) të kenë fituar pafajësinë, sipas ligjit nr. 7541, datë 30.09.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar; e) sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, të mos ketë kryer veprime të dëmshme, me pasojë për jetën e shetasve të tjerë gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991.

TABELA E THESARIT TE SHETITIT PER PAGESAT. Table with columns: I, MINISTRIA E FINANCARVE, KODI, NR, NIMI, NR E C.A., ACC, DESC, EMBL, FURNITORI, SHUMERA, DATA, REGJISTRIMI, DATA E KRYERJES, DATA E KRYERJES. The table lists various entries for the Treasury of the State, including items for the Ministry of Finance, and details such as account numbers, descriptions of goods and services, and dates of registration and completion.

BUXHETI

Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion dhe sipas radhës së caktimit të dëmshpërblimit, fondet do të ndahen në mënyrë proporcionale për të gjithë ish-të dënuarit dhe familjarët e viktimave të pushtuara, me kusht që vlera e dëmshpërblimit gjatë fazës së parë të mos jetë më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

PERFITUESIT

Përfiton dëmshpërblim i dënuari ose familjarët e viktimave të dënuara, të ekzekutuara apo të pushtuara. Për të përfitur dëmshpërblim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) të jetë dënuar me dënim kapital, heqje lirie, internim dhe dëbim apo të jetë izoluar në hetuesi ose në një institucion mjekësor psikiatrik, për shkak të një vendimi gjykatës të formës së prerë, të një akti administrativ apo të urdhrave të hetuesisë, të dhëna gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991

Kush përfiton dëmshpërblimin, të gjitha kategoritë e listuara



NDRYSHIMET Për të gjitha ndryshimet në përbërës, kërkesës duhet t'i bashkëlidhet edhe akti që i ka ndryshuar ato; b) të dhëna për periudhën e ekzekutimit (ditën)/vuajtjen e dënimit/dënimeve, hyrje-daljet nga burgimi, izolimi, internimi apo të dëbimi; c) vendimin e gjykatës, të formës së prerë/aktin e internimit, aktin administrativ apo dokumentin zyrtar që provon internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba.

trativ apo dokumentin zyrtar që provon internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba, apo aktakuzën

për izolim, nëse ka; c) dokumentacionin për gjendjen familjare aktuale të ish-të dënuarit politik; d) çdo infor-

macion, që ka ai për gabime ortografike apo materiale të përbërësve të gjendjes civile të tij, në vendim apo ak-

takuzë, për identifikimin e saktë të tij; dh) certifikatën e gjendjes civile, që provon të gjithë përbërësit e gjendjes civile dhe një adresë të saktë, të zgjedhur prej tij për komunikim. Certifikata duhet të jetë lëshuar jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës. Për ish-të dënuarit që nuk jetojnë, apo familjarët e viktimave, kërkesa paraqitet nga familjari, sipas rrethit të përcaktuar në këtë ligj. Në këto raste kërkesa paraqet dokumentacionin që provon lidhjen familjare me ish-të dënuarin politik, si dhe dokumentacionin që provon se cilët nga familjarët përfitues të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji janë të gjallë.

Qeveria akordon paketën e solidaritetit, 3 milionë euro për festat e fundvitit

Familjet me ndihmë, 3 mijë lekë shpërblim

Përfitojnë personat me aftësi të kufizuara dhe ato me ndihmë ekonomike

Qeveria vendosi dje të akordojë paketën e solidaritetit për familjet në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuara. "Çdo familje përfituese e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara do të përfitojnë 3 mijë lekë shpërblim, me rastin e festave të fundvitit. Kjo paketë solidariteti konfirmon edhe njëherë vëmendjen dhe përkujdesin e qeverisë për ata që kanë nevojë për përkujdes dhe mbështetje në këtë prag festash", tha ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu duke prezantuar paketën e fundvitit.

Qeveria ka përcaktuar një buxhet prej 396 147 000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë) lekë në funksion të paketës së solidaritetit të fundvitit.

VENDIMI I PLOTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes So-



Foto ilustruese

cialë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paafhtësisë kompensohen financiarisht, për vitin 2018, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- Familje, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;
- Familje, të cilat kanë

në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paafte për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar;

c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tet-

raplegjik", të ndryshuar;

c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar;

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 396 147 000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë) lekë dhe përballohen nga buxheti i ministrit të përgjegjës për çështjet so-

cialë, miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Përfitojnë: Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;

Jetimët, të cilët nuk janë në institucione;

Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë

njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;

Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes.

Fëmijët të vendosur në shërbimin e kujdestarisë.

Ministri i Financave: Shpërblim për studentët e ekselencës

Ahmetaj në "News 24": Hera e parë pas 28 vitesh që investohet në konvikte

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj tha se është hera e parë pas 28 vitesh që qeveria investon për rikonstruksionin e konvikteve në Qytetin Studenti. I futur në rubrikën "Opinion" në News24, Ahmetaj u shpreh se janë 19 milionë euro për rikonstruksionin e të gjitha konvikteve, ndërsa e konsideroi protestën e studentëve si të pastër dhe racionale. "Studentët e ekselencës do marrin shpërblim dhe këtë do e favorizojë buxheti i shtetit. Nëse është nevoja për të prekur ligjin e arsimit të lartë e prekim, por hajde ta diskutojmë dhe e ndryshojmë. Akti i parë i besimit është se një nga anëtarët që kemi në bord ne ia kalojmë studentëve. Është hera e parë në histori pas 1990 që investohet në konvikte. Unë kam jetuar vetë në konvikte dhe është hera e parë që investojmë në ato konvikte. Janë 19 milionë euro. Sot kryeministri ka folur me KfV që të vazhdojmë edhe me godinat e tjera. Ne e dimë që ka probleme dhe prandaj nisëm investimin. Kjo qeveri nuk ka nevojë që të shkundet për të kupa-



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, dje në "News 24"

ket kartës së studentit, Ahmetaj u shpreh se ajo do jetë si karta evropiane e studentit dhe do ketë shumë lehtësira. Ahmetaj kërkoi dialog, pasi sipas tij mazhoranca është e vetmja aleate e studentëve. Ministri tha se po kalohet në një pakt për universitetin dhe po diskutohet për realizimin e një bashkëbisedimi çdo tre muaj me studentët.

ket kartës së studentit, Ahmetaj u shpreh se ajo do jetë si karta evropiane e studentit dhe do ketë shumë lehtësira. Ahmetaj kërkoi dialog, pasi sipas tij mazhoranca është e vetmja aleate e studentëve. Ministri tha se po kalohet në një pakt për universitetin dhe po diskutohet për realizimin e një bashkëbisedimi çdo tre muaj me studentët.

Njoftim për shitje me ankand të dytë

Shqipëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. bazuar në adresën 577, 568 të K.Pi. Çirë ka shpallur shitjen me ankand të dytë për pasuritë e paluajtshme të gatisë dhe të tregut Ekspert Beton Lezhe sh.p.k. e.g.

* Tokë Arë* në Z.K. 1987 me numër pasurie 2038* Volumi 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2 me çmim fillësar prej 58.016 Euro

* Tokë Arë* në Z.K. 1987 me numër pasurie 4056* Volumi 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m2 me çmim fillësar prej 100.368 Euro

* Tokë Arë* në Z.K. 1987 me numër pasurie 2573* Volumi 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m2 me çmim fillësar prej 98.112 Euro

Aktuarit operonin hapur për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 14.01.2019 në orën 15.00, pranë shtetit në Bulvardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kall 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit mund të kontaktojnë 0672082543 dhe vizitohen faqen WEB www.powerjustice-al.com.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT
"AIRFIELD 2020" PROJECT
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e-mail, to all below e-mail address.

Upon receipt of the e-mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e-mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked: "CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 11 January 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Plotësimi i nevojave të të vegjëlve duke u dhuruar mjete didaktike

Aktiviteti për "Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara" vjen në ndihmë të fëmijëve

Programi artistik emocione për të pranishmit

Egla Xhemali


Më datë 18 dhjetor u zhvilluar një aktivitet, ku në qendër pati fëmijët që nuk dëgjojnë dhe shikojnë. Aktiviteti u organizua në kuadër të nismës vjetore të Kombeve të Bashkuara për 2018 "Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara dhe garantimi i përfshirjes dhe barazisë së tyre" dhe festave të fundvitit, nga Qendra Komunitare për Shërbime Komunitare (QKShk) në Tiranë në bashkëpunim me nxënësit dhe mësuesit e Institutit të Nxënësve që nuk dëgjojnë dhe Institutin e Nxënësve që nuk shikojnë, Bankën Botërore, Zyrën e IFC-së, Teleperformancën Albania, nxënësit të shkollës "London School" në Tiranë. Fryma e festave të fundvitit ishte e pranishme ditën e martë në të dy Institutet e Nxënësve me Aftësi të Kufizuara (i Nxënësve që nuk shikojnë dhe i nxënësve që nuk dëgjojnë). Në prani të Bankës Botërore, IFC-së Teleperformancë, nxënësve të "London School" dhe Qendrës Komunitare për shërbime komunitare. Prindër, mësues dhe nxënësit të dy institutive, përfaqësues të institucioneve të lartpër-



mendura festuan së bashku dhe ndoqën një program të larmishëm artistik me këngë, valle, instrumentale, recitime dhe pantonima. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që të angazhonte fëmijët me vepërimtari të ndryshme në lidhje me artet, si dhe t'u ofronte dhurata atyre në kuadër të festave të fundvitit. Mes harmonisë dhe

buzëqeshjeve fëmijërore u kalua kështu një dy orësh i përgjendruar i gjithi tek fëmijët dhe lumturia e tyre. Bashkëpunimi efektiv mes këtyre institucioneve synoi të plotësojë disa nga nevojat e shumta të të vegjëlve duke u dhuruar mjete didaktike dhe pajisje për piktura, bojëra profesionale, kanavacë e tela, penela, magnetofonë me

disk, USB e MP3, lodra, veshje, çanta etj. Natyrisht që dhuratat janë më shumë se simbole duke marrë parasysh përjetimet e fëmijëve ndërkohë që i kishin në duar ato. Pjesëmarrësit përjetuan emocione të veçanta mes këtyre fëmijëve që kanë shumë nevojë për dashuri, vëmendje dhe ndihmën e gjithë shoqërisë.



Sherr mes Ermal Mamaqit dhe Luana Vjollcës, zbuloni çfarë ka ndodhur mes moderatorëve

Përplasjet mes moderatorëve nuk kanë të mbaruar. Emisionet e tyre të së shtunës janë bërë 'mollë sherri'. Kështu Luana ka vënë re postimin e moderatorit me studion plot me artistë dhe i shkruan: "Pse më kopjon me shumë të ftuar". Sigurisht që Ermali nuk e ka lënë pa përgjigje Luanën: "Ne po festojmë Krishtlindjet dhe kemi edicion special. Dhe s'të kopjon njeri ty. Në fakt, ne po kopjonim 'Top Show' - i përgjigjet Ermali. Theksojmë se Ermali dhe Luana janë ndër figurat më të pëlqyera të show bizzit shqiptar.



View Insights

Promote



Liked by [redacted] and 3 514 others
ermalmamaqiofficial mos harro sot ora 21. Xing me Ermalin
View all 41 comments

luanavjollca Jane te zene sonte 😊
ermalmamaqiofficial @luanavjollca të lutem dil nga jeta ime. si munde... ej shiko... javës tjetër po nuk e pate bezi ma jep mua atë fustanin e bardhë. edhe unë kam ndjenja...edhe unë kam gjoks. 😊
14 MINUTES AGO · SEE TRANSLATION

Noizy shifra marramendëse për veshjet në klipin e ri, ja sa ka shpenzuar reperi

Reperi i njohur Noizy njihet për shpenzimet e tij të shumta në veshje apo aksesore. Ditët e fundit ai ka publikuar videoklipin e ri me emrin "Gango" dhe ajo çfarë ka rënë në sy është veshja. Sipas faqes në 'Instagram' "Whattheywearin", bluza në videoklip është e firmës 'Amiri, Tie dye stars hoodie', dhe kushton 1.345 euro. Ndërsa atletet në ngjyrë të kuqe janë 'Louboutin, Louis junior spikes veau velours', shuma e të cilave është 665 euro. Në total kjo veshje e reperit ka kushtuar 2.010 euro duke mos marrë parasysh vendet luksoze që ai ka zgjedhur për të xhiruar.



Shoferë! Kujdeseni gjithnjë për sigurinë e pasagjerëve gjatë udhëtimit?

Le të kujdesemi ne për sigurinë tuaj!

Në jetën e përditshme përballimi me situata nga më të papriturat. Por duke filluar nga vetëm 2,000 Lekë/vit, siguria juaj është më e lehtë se kurrë me sigurimin Jetë dhe Aksidente!

- Përfitim në rast humbje jete për shkak sëmundjeje apo aksidenti
- Mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast aksidentesh
- Përfitim për paaftësi të përhershme apo të përkohshme, të plotë apo të pjesshme
- Zbritje deri në 60% në spitalet dhe klinikat private pjesë të rrjetit mjekësor SiCRED

**SIGURIMI
JETË dhe AKSIDENTE**

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: **Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al**

DIALOGU KOSOVE - SERBI REAGIMET

Formimi i FSK, sekretari i NATO-s: Do të vazhdojmë misionin për sigurinë e vendit

Stoltenberg, bisedë telefonike me Haradinajn: KFOR vijon në Kosovë

Thaçi: Ushtria e Kosovës mbështetet nga ndërkombëtarët

Ditën e djeshme, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg ka zhvilluar një bisedë telefonike me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj. Kryefjala e diskutimit ka qenë angazhimi i KFOR-it në Kosovë. "Ndërsa mandati i FSK-së po evoluon, Këshilli i Atlantikut të Veriut do të shqyrtojë nivelin e angazhimit të NATO-s me FSK-në vitin e ardhshëm. NATO do të vazhdojë misionin e KFOR-it për të siguruar një mjedis të sigurt në Kosovë. KFOR-i vepron nën një mandat të OKB-së dhe nuk do të ndikohet nga ligjet për transformimin e FSK-së", është shprehur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Kujtojmë se javën e kaluar Kuvendi miratoi krijimin e Ushtrisë së Kosovës. Nga ana tjetër, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi pas takimit në Bruksel, në një deklaratë për mediat tha se themelimi i Ushtrisë së Kosovës ka marrë mbështetjen e vendeve më të fuqishme të botës. "Themelimi i Ushtrisë së Kosovës është një punë e kryer, ka marrë mbështetjen më të fuqishme prej vendeve më të fuqishme të botës. Kam marrë një mbështetje edhe para fillimit të punës së seancës së jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, edhe 8 vende, të cilat do të jenë publikisht me një deklaratë të përbashkët. Dëshiroj të falënderoj gjitha këto vende, Francën, SHBA-të, Kuvajtin, Poloninë, vende që i dhanë mbështetjen e duhur, por tek e fundit ky është një vendim i Kosovës, i të zgjedhurve dhe institucioneve të vendit. Duhet të fokusohemi në fuqizimin e Ushtrisë së Kosovës, profesionalizimin, që është dhe do të mbetet në shërbim të qytetarëve, në territorin e Kosovës, ndaj dua të theksoj se themelimi i ushtrisë është një punë e kryer dhe e afirmuar në rrafshin ndërkombëtar", u shpreh ai. Ndërkaq, zëvendësndihmësi i sekretarit të përgjithshëm të NATO-s për çështje politike dhe politika të sigurisë, James Appathurai, ka thënë para dy ditësh se brenda NATO-s nuk përmendet mundësia e largimit të KFOR-it nga Kosova dhe as ndryshimi i mandatit të tij, derisa shton se as në Kombet e Bashkuara nuk është shqyrtuar diçka e tillë. "Mendoj se është shumë e rëndësishme të theksohet se roli i KFOR-it në një mjedis të sigurt nuk është i hapur për pyetjen apo diskutimet brenda NATO-s. Siç thashë, në kemi një mandat nga OKB-ja dhe do të vazhdojë të zbatohet. Mendoj se është baza më e rëndësishme për sigurinë dhe stabilitetin jo vetëm në



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg



Veseli: BE-ja të na trajtojë njësoj si Serbinë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës ka kërkuar nga Bashkimi Evropian që të trajtojë seriozisht çështjen e taksës që Kosova ka vendosur ndaj produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Veseli në një konferencë për media tha se rruga e Kosovës drejt Bashkimit Evropian nuk ka kaluar dhe nuk do të kalojë nga Serbia. "Kemi pritur reflektim të balancues të Bashkimit Evropian për këtë situatë, por nuk kemi pritur që Bashkimi Evropian të reagojë vetëm ndaj nesh. Kjo mungesë balance e BE-së te qytetarët e Kosovës me të drejtë ka krijuar përshtypjen e njëanshmërisë së BE-së", tha Veseli. "Thirrjet e Serbisë për heqjen e taksës dhe përsëritja e tyre nga BE-ja pa i bërë thirrje edhe Serbisë që të heqë dorë nga qasja e saj bllokuese ndaj Kosovës po shqetëson me të drejtë qytetarët e Kosovës. Kosova nuk do të veprojë njëanshëm në heqjen e taksës", u shpreh Veseli. Ai tha se bllokimi i qytetarëve të Kosovës pa lëvizje të lirë vetëm sa e veshëtitëson edhe më shumë këtë situatë.

Letra e Trump, Thaçi: Ngjan me kërcënimin që iu bë Millosheviçit

Presidenti i SHBA-ve paralajmëron për marrëveshje me Serbinë në Shtëpinë e Bardhë

Kreu i Kosovës, Hashim Thaçi ka komentuar nga Brukseli letërën e Presidentit të SHBA-ve, Donald Trump. Ai tha se letra e tij mund të krahasohet me kërcënimin e ish-presidentit amerikan, George H.W Bush për Millosheviç, në vitet e luftës me Kosovën. "Mendoj se mesazhi i presidentit Trump është mesazhi i SHBA për qytetarët e Kosovës, në mënyrë që ta mbyllim këtë proces të rëndësishëm në njohje reciproke. Mund të krahasohet edhe me mesazhe që i ka dhënë Bush i vjetri, i cili ka kërcënuar Millosheviçin. Është një qëndrim shumë i qartë me mbështetje unike

dhe reflekton se SHBA do të jetë pranë nesh dhe me mbështetje të plotë", u shpreh Thaçi. Presidenti amerikan, ka përmes kësaj letre u ka kërkuar liderëve politikë në Kosovë që të kenë unitet në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë. Në të thuhet se kjo marrëveshje është një mundësi për Kosovën dhe humbja e saj do të ishte kthim mbrapa për një kohë të gjatë. Trump paralajmëron marrëveshje historike me Thaçin e Vuçiçin në Shtëpinë e Bardhë. "Liria dhe pavarësia e Kosovës janë rezultat i luftës sonë të drejtë dhe përkrahjes së aleatëve tanë strategjikë ndërko-

mbëtarë. Realizimi i synimeve tona për anëtarësim në NATO, BE dhe OKB është i pamundur pa përkrahjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare. Respekti dhe ndihma duhet të jenë reciproke dhe jo të njëanshme. Prandaj është detyrimi ynë që t'u përgjigjemi pozitivisht thirrjeve dhe kërkesave miqësore, që vinë nga SHBA-të. Një kërkesë e tillë miqësore, por në të njëjtën kohë shumë serioze me është bërë drejtpërsëdrejti nga Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump", ka thënë Thaçi.

Vuçiç: Bisedimet me Kosovën vijojnë kur të hiqet taksa

Kreu i shtetit serb, Aleksandar Vuçiç iu tha zyrtarëve të lartë të BE-së se Serbia është e angazhuar për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, mirëpo e vetmja mënyrë për të vazhduar bisedimet me Prishtinën është nëse tërhiqet tarifa prej 100 për qind ndaj mallrave serbe. "E vetmja mënyrë për të krijuar kushtet në të cilat vazhdimi i bisedimeve do të ishte i mundur është që Prishtina të tërhiqej nga vendime të paligjshme dhe krejtësisht të paarsyeshme", - tha presidenti Vuçiç pas takimit me presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk. Gjatë takimit, Vuçiç ka përmendur transformimin e FSK-së, duke thënë se ky vendim është në kundërshtim me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ndërkohë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se në javët dhe muajt në vazhdim do të gjendet zgjidhja për një marrëveshje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë. Në një deklaratë për mediat në Bruksel, Thaçi tha se letra e Presidentit Donald Trump, drejtuar atij, konfirmon qëndrimin e SHBA-të do të qëndrojnë pranë Kosovës dhe do ta përkrahin atë në këtë fazë të arritjes së marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. "Këtë angazhim të gjithanshëm ndërkombëtar të SHBA-ve dhe BE-së nuk guxojmë ta humbim apo të lëmë të kalojë, sepse mund të paguajmë çmim të lartë të mosinteresimit ndërkombëtar", theksoi Hashim Thaçi.

Kosovë, por edhe në rajon", ka thënë Appathurai. Ai po ashtu ka shtuar se NATO është e shqetësuar se vendimi për formimin e Ushtrisë së Kosovës nuk do të sjellë stabilitet më shumë dhe se mund të ketë efekt të kundërt. "Sekretari i Përgjithshëm ka qenë shumë i qartë në lidhje me shqetësimet e tij dhe të NATO-s. Një nga fjalët kyçe që ai ka përdorur ka qenë 'i parakohshëm'. Ne jemi të shqetësuar se kjo nuk do të

çojë në stabilitet më të madh, përkundrazi. Nuk ishte koha e duhur për ta ndër marrë këtë hap. Aleatët e ndryshëm kanë shprehur pikëpamjet e tyre kombehtarë, por kjo është pikëpamja e udhëheqjes së NATO-s", ka thënë ai në një intervistë për "European Western Balkans". Appathurai po ashtu ka theksuar se NATO është duke diskutuar se çfarë lloj mbështetjeje do të ofrojë tani në Kosovë. "Çfarë do të ndodhë tani është

të një diskutim brenda NATO-s në lidhje me rolin mbështetës dhe si ose nëse ajo ecën përpara. Sekretari i Përgjithshëm ka qenë shumë i qartë që nga fillimi, kur erdhi ideja e parë, se ky rol do të duhej të rishikohet nëse Prishtina ndërmerri hapa, të cilat i mori javën e kaluar. Unë mendoj se së shpejti do të fillojmë me diskutimin me aleatët rreth asaj se çfarë lloj mbështetjeje do të vazhdojë të jap NATO, ose jo", ka thënë Appathurai.

Shtëpia e Bardhë hedh poshtë pretendimet për Gylenin

Turqia akuzon Trump për ekstradimin e klerikut mysliman, zyrtari amerikan: S'është e vërtetë



Kleriku mysliman Fethullah Gylen

ZYRTARI I LARTË

"Gjatë takimit me Presidentin turk, Erdogan, në samitin ekonomik të G-20s në Buenos Aires, presidenti Trump nuk bëri ndonjë premtim për ekstradimin e Fethullah Gylenit", ka thënë një zyrtar i lartë i Shtëpisë së Bardhë.

Çauhallu, tha më parë në rrjetin televiziv 'CNBC' se zoti Trump i kishte komunikuar presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan se SHBA-të

janë "duke punuar për ekstradimin" e Gylenit dhe "njerëzve të tjerë". Gyleni jeton në mërgim në Pensilvani. Turqia e akuzon atë për

orkestrimin e grushtit ushtarak të shtetit kundër Presidentit Erdogan në vitin 2016, shkruan VOA. Gyleni e mohon akuzën, por Ankaraja ka kërkuar që Shtetet e Bashkuara ta ekstradojnë atë në Turqi. Shtetet e Bashkuara kanë thënë se Turqia nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme që mbështesin pretendimin e saj kundër Gylenit. Zoti Çauhallu tha se ai ka parë një hetim "të be-

sueshëm" të FBI-së që tregon se si organizata Gylen i shmanget pagimit të taksave. Zoti Erdogan tha javën e

kaluar se qeveria e tij do të fillojë të verë në shënjestër ata që financojnë operacionet e Gylenit.

Këshilltari i Trump për sigurinë kombëtare, Bolton: Jemi me Ramën dhe me Shqipërinë kundër terrorit

Rama dëbon ambasadorin e Iranit nga Shqipëria

Arsyeja: Cënim për sigurinë kombëtare. Në mars 2 iranianë u arrestuan

Kryeministri Edi Rama ka shpallur non-grata ambasadorin e Iranit në Shqipëri dhe e ka dëbuar nga vendi bashkë me një diplomat tjetër, me argumentin se përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare.

Ky veprim është mbështetur nga krahu i djathtë i presidentit Trump, këshilltari për sigurinë kombëtare i SHBA, Xhon Bolton.

"Kryeministri i Shqipërisë shpallni të padëshirueshëm ambasadorin e Iranit, duke i dhënë një mesazh liderëve iranianë se ndihma që ata i japin terrorizmit nuk do të tolerohet. Ne jemi përkrah kryeministrit Rama dhe popullit shqiptar në kohën që ata i qëndrojnë fort sjelljes së gabuar të Iranit në Europë dhe në botë", shkruan Bolton në Twitter.

Më herët "Top Channel" kishte mësuar se Shqipëria ka marrë vendim për shpalljen si persona të padëshiruar të dy diplomatëve të ambasadës së Republikës Islamike të Iranit, të cilët dyshohen të jenë përfshirë në aktivitete që çojnë në sigurinë në vend. Në përgjigje të interesit të Top Channel, zëdhënësja e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme e konfirmoi këtë informacion.

Sipas zëdhënësës së MEPJ-së, "vendimi për shpalljen e diplomatëve iranianë si të padëshiruar është marrë në konsultim me vendet aleate, për shkak të aktivitetit të tyre në Shqipëri në kundërshtim me statusin e tyre diplomatik".

Burime jozyrtare i thanë Top Channel se ky vendim, me gjasë vjen pas një bashkëpunimi me shërbimet partnere dhe ato izraelite për të



shmangur një incident gjatë ndeshjes në Shkodër. Në atë kohë kishte informacion se Lavdrim Muhaxheri dhe disa terroristë të tjerë do të sulmonin me eksploziv kombëtarin izraelite. Për këtë çështje, në Shqipëri dhe Kosovë u arrestuan më shumë se 20 persona. Pak muaj më parë, Shqipëria shpalli "non grata" atashen ushtarak të Rusisë në vendin tonë, si dhe sekretarin e parë të Ambasadës ruse.

ARRESTIMET NE MUJIN MARS

Asokohe pati raportime në media, por asnjë njoftim zyrtar nga institucionet shtetërore. Lajmi ishte se autoritetet shqiptare arrestuan disa persona të dyshuar për terrorizëm në mars të këtij

viti. Sot vjen konfirmimi zyrtar: Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo ka publikuar raportin e Departamentit të Shtetit "Aktiviteti operacional i Iranit në Europë", ku thuhet shprehimisht se, në datën 22 mars 2018, 2 operativë iranianë janë arrestuar në Shqipëri me akuzën e terrorizmit. Sekretari Pompeo shkruan gjithashtu në Twitter se: "Regjimi i Iranit ka sjellë vuajtje dhe vdekje për botën dhe për popullin e vet. Vetëm në Europë, vrasjet, bombardimet, dhe sulmet të tjera terroriste të sponsorizuara nga Irani kanë dëmtuar jetë të panumërta. Shpresoj që europianët ta ngrenë këtë çështje me Rouhani & Zarif në turin e tyre europian."

LARGIMI

"Kryeministri i Shqipërisë shpallni të padëshirueshëm ambasadorin e Iranit, duke i dhënë një mesazh liderëve iranianë se ndihma që ata i japin terrorizmit nuk do të tolerohet. Ne jemi përkrah kryeministrit Rama dhe popullit shqiptar në kohën që ata i qëndrojnë fort sjelljes së gabuar të Iranit në Europë dhe në botë", shkruan Bolton në Twitter.

Mogherini mbledh në Bruksel krerët e Ballkanit Perëndimor

Ditën e djeshme shefja për Politikë të Jashtme dhe Siguri e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini zhvilloi një takim joformal me liderët e Ballkanit Perëndimor në Bruksel. Në këtë takim morën pjesë edhe komisioneri për Zgjerim i BE-së, Johannes Hahn; Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksander Vuçiq, ku do të diskutohet për zhvillimet e fundit mes dy shteteve. Përveç Thaçit e Vuçiq, në takim do të jenë të pranishëm edhe kryeministri Edi Rama; Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, kryeministri maqedonas, Zoran Zaev dhe kryetari i Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, Denis Zvizdiç. Ndërkohë që një ditë më parë Haradinaj zhvilloi një takim me Mogherinin.



SHKURT

Itali/ Prostituta shqiptare rikthen portofolin që gjen në karburant

Sinqeriteti dhe shpirti i mirë mund të gjenden edhe në vende të paimagjinueshme. Një prostitutë shqiptare, e cila gjeti një portofol pranë një karburanti ka befasuar me gjestin e saj. Mediat italiane shkruajnë se prostituta shqiptare, 22 vjeç, gjeti një portofol me 150 euro afër një karburanti dhe vendosi t'ia dorëzonte policisë. Portofoli i kishte humbur një shtetase italiane, e cila e kishte kuptuar vetëm mëngjesin tjetër mungesën e tij. Brenda në portofol përveç parave, kishte edhe plot dokumente. Pasi mori portofolin, shtetësja italiane vendosi të falënderonte vajzën, e cila kishte bërë thjesht detyrën e saj. "Nuk e ka zgjedhur të bëjë këtë punë, e kanë detyruar të qëndrojnë në rrugë. Kur ka parë portofolin, e ka mbledhur fshehurazi. Kishte frikë se dikush e shikonte dhe i merrte paratë dhe hidhte dokumentet. Donte ta dorëzonte siç ishte", rrëfeu italianja pas takimit me shqiptaren.

Londër/ Qëllohet për vdekje një person, tre në pranga

Një person ka mbetur i vdekur pas disa të shtënave me armë zjarri në Londrën Veriore. Policia raportoi se mori informacione për një të plagosur në rrugën "St Joseph" rreth orës 9:15, të martën. Viktima, moshë dhe identiteti i të cilit ende nuk bëhet e ditur, u shpall i vdekur në skenën e krimit rreth orës 10:10 të darkës. Të paktën 3 meshkuj u arrestuan në skenën e krimit, raportoi policia. Ende nuk ka asnjë informacion për të plagosur të tjerë.

FESTIVALI



Ermal Meta në festival: Këtu kam rrënjët e mia

Këngëtari shqiptar Ermal Meta është i ftuar special në natën e parë të Festivalit të Këngës në edicionin e '57. Artisti, fitues i "Sanremo" 2017, ka mbërritur mbrëmjen e djeshme në Tiranë ndërsa pasditen e së mërkurës në Pallatin e Kongreseve ai doli përballë gazetareve duke mbajtur një konferencë për shtyp.

Vetë artisti u shpreh se ndjehej i nderuar që do të performonte në skenën e Festivalit si i ftuar special e jo vetëm kaq, por se është i privilegjuar që është këtu pasi siç u shpreh edhe vet "këtu kam rrënjët e mia".

Ai zbuloi për mediat se në momentin që i erdhi ftesa për Fest '57 nuk tha menjëherë "Po" dhe kjo jo për shkak se nuk donte të ishte i pranishëm, por, sepse nuk e dinte nëse do të ishte në gjendje dhe i gatshëm për të përjetuar një emocion të tillë.

"Pastaj mendova që është një nder i madh për mua. Kur jam larguar përpara 24 vitesh nga Shqipëria nuk e mendoja që do të isha i ftuar ndonjëherë në Festival", - u shpreh artisti shqiptar. Gjatë kë-



Këngëtari do këndojë live natën e parë, vlerëson Elhaida Danin e Eugent Bushpepën

tyre viteve, këngëtari tregoi se e ka ndjekur festivalin e RTSH e madje mban mend disa vija melodike të këngëve, por ai ka qenë më

//
Meta u shpreh se e ka ndjekur festivalin ndër vite e madje mban mend edhe disa vija melodike këngësh shqiptare, por që më shumë ka qenë i prirur nga muzika klasike

i prirur drejt muzikës klasike. I pyetur nga gazetarët se sa e

ndjek muzikën shqiptare, Meta u shpreh se e ka ndjekur festivalin ndër vite e madje mban mend edhe disa vija melodike këngësh shqiptare, por më shumë ka qenë i prirur nga muzika klasike. Ndër artistët shqiptarë që ai ka mundur të shohë kohët e fundit, përmendi fituesin e "The Voice Italy" Elhaida Dani për të cilën shprehu edhe vlerësimet maksimale e ndërsa për fituesin e vjetshëm të Festivalit të Këngës, Eugent Bushpepa lidhur me performancën në Eurovizion tha: "Eugent Bushpepa na la me gojë hapur".

Ermal Meta do të performojë live në natën e parë të 'Fest '57' më datë 20 dhjetor me orkestrën e Radio Televizionit Shqiptar dy këngët e tij më të njohur "Non mi aveta fato niente", me të cilën ka fituar edhe Sanremo 2017 si dhe "Piccola Anima", si dhe ka premtuar edhe një surprizë tjetër.

"SONATË PËR GRUAN E NJË TJETRI" E "ARMËPUSHIMI" MARRIN ÇMIM NGA MINISTRIA

Një autor shqiptar dhe një përkthim vlerësohen nga juria

Ministria e Kulturës organizon dje ceremoninë e ndarjes së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2017, "Vepra letrare më e mirë e vitit" dhe "Vepra letrare më e mirë e vitit e përkthyer". Juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë e përbërë nga Parid Teferiçi, në cilësinë e kryetarit të jurisë dhe anëtarët: Alma Mile, Olimbi Velaj, Agim Baçi, Albert Gjoka, bën të ditur listën e shkurtër me 5 libra të përzgjedhur nga autorët shqiptarë dhe me 5 libra të përkthyer, të cilët vazhdojnë garën për çmimet: "Vepra letrare shqiptare më e mirë e vitit" dhe "Vepra letrare e përkthyer më e mirë e vitit" për vitin 2017. Çmimin për përkthimin më të mirë e mori Aida Baro për "Armëpushimin" e Primo Levit me motivacionin: "Për besnikërinë e frymëzuar gjatë përcjelljes së një mesazhi nga shekulli tragjik i ideologjive, në shqipërimin e një dëshmie ku përjetimi në vetë të parë i çnjerëzores kthehet në për-

jetësim të imperativit etik të njerëzimit". Romani i përkthyer nga Aida Baro, me siglën e Botimeve "Pegi" është cilësuar nga kritika si një vepër që shërben për të dekonstruktuar forcat e së keqes. Triumfi i identitetit njerëzor dhe vlerave të tij mbi patologjinë e shkatërrimit të njeriut shkëlqen kudo në shkrimësinë e Levit. Për shumë arsye, veprat e tij zënë një vend të veçantë ndërmjet pasurisë së Letërsisë së Holokaustit. "Armëpushimi", libri i kthimit, odiseja e Europës mes luftës dhe paqes, është vijimi i "A është vallë, njeri...?" një ndër librat më të bukur të letërsisë europiane lindur nga kampet e shfarosjes. Çmimin për veprën më të mirë shqipe e mori Henrik S. G. "Sonatë për gruan e një tjetri" me motivacionin: "Për trysinë e fortë evokative të prozës së tij, e veçantë në universalitetin që shpalos, ku personazhet dhe lexuesit luhaten së bashku mes ngutit të dëshirës dhe



kohës së pamjaftueshme për kujtesën. Romani i Henrik S.Gtin që shpalos, ku personazhet dhe lexuesit luhaten së bashku mes ngutit të dëshirës dhe kohës së pamjaftueshme për kujtesën. Romani i Henrik S.G. "Sonatë për gruan e një tjetri", nga Botime "Dudaj" është një vepër psikologjike. Au-

tori është shqiptar, nga Vlora dhe një shkrimtar i ri shqiptar që sjell një histori dashurie. Autori rrëfen historinë e nënës së tij. Chère madam De Laduset, ma chère Charlotte! Ju lutem, mos më gjykonni tani, jo tani me sedrën tuaj të lënduar! Lëreni kohën të rrjedhë dhe ndoshta, ndonjëherë,

me shpirt të lehtësuar do të ndieni pak keqardhje për mua. Në degëzimet e pemës sime gjenealogjike, kam zbuluar se jo një herë burrat paskan qenë marrosur nga dashuria për gruan e një tjetri. Por askush prej tyre nuk qenka vetëvrarë, nuk paska qenë në kulturën e stërgjyshërve të mi Le Suicide! Edhe mund ta kisha ndryshuar rrjedhën e historisë së familjes sime. E pata menduar edhe këtë mundësi, atëherë kur më ra rrufeja në kokë. Por as besimi prej katoliku nuk më vlejti për këtë rast. Nuk mund të prisja një shekull për t'u takuar në botën tjetër me gruan, pa siluetën e së cilës unë nuk jetoja dot as edhe një ditë. Dhe që është mallkim, apo jo? Ne jemi burra të fuqishëm për të luftuar, për të bërë politikë, për të shtuar pasuritë e të parëve tanë. Por jemi aq të dobët para gruas që na pushton shpirtin... Lamtumirë!

DOSSIER

Enver Hoxha, si e fshehu takimin sekret me Mustafa Krujën

Nga Nga Ylli Polovina

Mustafa Kruja i tha Hasan Alizotit "Hiqe qafe këtë", ai u përgjigj: I kam dhënë fjalën, nuk e bëj dot

Enver Hoxha midis shumë të pathënave të jetës së vet politike nuk ka rrëfyer edhe një takim që ka kryer në fshtësi me kryeministrin Mustafa Kruja, mandati i të cilit u ushtrua prej janarit 1942 deri në të njëjtin muaj të vitit të mëpasshëm. Që ky i fundit, i cili ndërmori një cikël takimesh sekrete me drejtues të Lëvizjes Nacionalçlirimtare për të gjetur një kompromis mosluftimi me ta.

Kontakti me Hoxhën, duke qenë se nuk ka burime të shkruara dhe na është pohuar vetëm prej Abaz Fejzi Alizotit, bashkëkombës afro tetëdhjetëvjeçar, i cili jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka të ngjarë të ketë ndodhur në periudhën e gjysmës së parë të motit 1942, ndoshta kur ende E. H. nuk qe zgjedhur shefi i partisë së komunistëve dhe po ashtu i armatës së saj partizane.

Takimi mes Mustafa Krujës dhe Enver Hoxhës u bë në rrugën me emrin e sotëm "Siri Kodra", në shtëpinë e një komunisti nga Libohova, emrin të cilit Alizoti nuk e mban mend. Ai pohon se, sipas asaj që i ka thënë i ati, Hasani, i cili ishte ndërmjetësi i realizimit të këtij kontakti, të dy bashkëbiseduesit vajtën në takim natën, në errësirë të plotë dhe biseduan gjatë. Megjithatë nuk ranë dakord për asgjë. Qenë në pozita shumë të kundërta.

Kur Mustafai u ngrit të ikte dhe po dilte nga dera e dhomës, saktësisht duke filluar të zbrishte shkallët poshtë, i tha Hasan Alizotit turqisht këto fjalë: "allta kellanen xhani ceksen". Këto donin të thoshin: "Të fundit i daltë shpirti". Kjo në turqisht nënkuptonte "Hiqe qafe këtë!".

Ndërkaq Hasani u përgjigj: "I kam dhënë fjalën, nuk e bëj dot".

Hasan Alizoti ishte këtë kohë prefekt i Beratit, pra nëpunës i caktuar ato çaste prej vetë kryeministrin Mustafa Kruja. Kur kish të mbërritur me këtë detyrë pati vënë re se qyteti i lashtë që përfshirë në një aktivitet rezistence antitaliane shumë të fortë, daluar mjaft prej qyteteve të tjera. Për ta shuar apo dobësuar atë, sigurisht, e dërguan ata të qeverisë bashkëpunuese me komandën e trupave italiane të pushtimit, por ndërkohë rrodhën rrethana që i dhanë një drejtim tjetër qëndrimit të Hasan Alizotit.

TAKIMI TOP SEKRET NË MANASTIRIN E ARDENICËS

Një ditë Hasani i erdhi në rrugë private një mesazh tepër i veçantë, as i imagjinuar. E kërkonte për një takim "kokë më kokë" një oficer madhor britanik. Anglezi me këtë rast i pati përcjellë edhe temën e bisedimeve: "Problemet e kohës". Ai e analizoi gjatë ofertën e rrethësimeve po ta merrnin vesh epërret e tij e sidomos ata të strukturave fashiste italiane, përfshi edhe Mëkëmbësinë, por duke qenë adhurues i demokracive perëndimore, pranoi.

Takimi u krye në Manastirin e Ardenicës. Oficeri i lartë britanik erdhi deri në bregdet me një mjet lundrues, ndoshta i zbarkuar prej ndonjë nëndetëseje. Prej andej erdhi në Manastir. Nga çfarë tja dhe si u soll gjatë bisedës shtfaq personalitetin e një njeriu të kulturuar. Fliste frëngjisht dhe me këtë gujë që të dy shkëmbyen mendime rreth luftës që po zhvillohej jo vetëm në Shqipëri. Në fund anglezi shqiptoi: "Misioni im është t'ju rekomandoj: të lutem shumë, mos ia prish qejfin Lëvizjes Nacionalçlirimtare!"



Hasan Alizoti në Legatën Shqiptare, Athinë 1928

Pas kësaj u ndanë secili në punën e vet. Ndërkaq më vonë Hasan Alizoti do të merrte vesh se po ai ushtarak, si edhe të tjerë, nuk e kishin të parin këtë takim të fshtë me prefektin të veçantë shqiptarë. Gjithsesi kjo bisedë e bëri Hasenin të kuptonte më mirë se për shtetet perëndimore antifashiste ato çaste bashkëpunimi me grupet e armatosura të inkurajura apo të drejtura edhe prej komunistëve, kishte një rëndësi shumë jetike, madje edhe për vetë ekzistencën e demokracisë. Përballja strategjike me bolshevizimin hë për hë duhej pezulluar, sepse Hitleri dhe Musolini, po ta fitonin Luftën e Dytë Botërore, do ta mbytnin demokracinë kudo ndodhej, në Londër apo deri edhe në Uashington. Tashmë e patën kryer këtë dhumë në Paris, Vjenë, Pragë, Varshavë, Bruksel... Falë këtij takimi Hasan Alizoti kuptoi kahun e lëvizjes së ngjarjeve në ato momente dhe vendosi të ndjekë këtë kurs, me pak fjalë të zbatojë çfarë i propozoi oficeri i lartë britanik.

Në Berat edhe më parë kësaj bisede ai qe munduar të qëndronte jashtë përplasjes mes palëve, në një pozicion baraspeshimi, përherë për të siguruar një jetë të qetë të banorëve dhe sipërmarrjeve të tyre ekonomike. Megjithatë ndaj të rinjve të rezistencës antifashiste, komunistë ose jo, shprehte anësim. Kur ndodhte që ata binin pre e italianëve, sidomos e një drejtuesi lokal karabinierie, individ i egër, marshallit Antonio Martini, mudohej t'i shpëtonte nga thonjtë e tij. Në një rast u bë krah, në mos edhe nismëtar, edhe vetë i ati, Fejzi Alizoti.

Në atë kohë Fejziu qe emëruar në Kosovë si komisar civil për tokat e çliuruara. Mbanete afër edhe dy oficerë të milicisë shqiptare. Njëri ishte Xhevat Libohova, kunat i të bir-it, Hasanit, domethënë vëllai i gruas së këtij, Hiqmetes. Tjetri oficer milicie shoqërues i Fejzuit qe Xhelal Staravecka. Që të dy ishin njerëz të aksionit dhe sapo Hasani nisi punën e prefektit në Berat, i ati ia dërgoi në përforcim.

Kur PKSH vendosi që nga Tirana për të organizuar rininë e saj antifashiste në Berat të dërgonte Alqi Kondin, njerëzit e marshall Martinit e arrestuan që të nesërmen e mbërritjes. Ia filluan menjëherë torturimin e rëndë. Atëherë Fejzi Alizoti e telefonoi të

birin dhe i tha: "Bëj çfarë të duash, por Alqi, djalin e doktor Kondit, ta liros!" Hasani thirr menjëherë drejtuesit e kuesturës dhe tërthorazi e pyeti për të arrestuarit që kishin. I përmendën edhe emrin e Alqi Kondit. "Me çfarë pune të ndaluar është marrë?", i pyeti. "I ka pohuar vetë fajet që të gjitha", iu përgjigjën shkurt. "Atëherë ma bini këtu ta pyes njëherë vetë!" Ia sollën të nesërmen. Porsa hyri në zyrën e prefektit Alqi nderoi me dorën lart si fashist. Ishte me shumë plagë e shenja të gjakosura. Mezi qëndronte në këmbë. "Ule dorën", i tha Hasan Alizoti. Kondi i ri u hutua, sepse nuk e priste këtë prej një prefekti të emëruar nga fashistët. "Je shqiptar, shtoi ky, dhe ne kemi nderim tjetër". Në vijim Hasani e këshilloi që sapo të rikthehej në burg të kërkonte një vizitë mjekësore për gjendjen e tij shumë të rëndë shëndetësore. "Madje bërtiti, i tha, thirr me të madhe deri sa të të sjellin doktorin". Alqi



Hasan Alizoti, 1942.

Kondi veprimi si i tha prefekti dhe fitoi mundësinë të shtrohej në spitalin e burgut të Tiranës. Hasani informoi të atin për sa kishte bërë si edhe lajmëroi njerëzit në kryeqytet të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Këta shumë shpejt organizuan arratisjen e Alqi Kondit.

Ndërkaq pas takimit sekret me oficerin e lartë britanik Hasan Alizoti kishte nisur komunikimet e fshehta me drejtuesit lokalë të rezistencës së armatosur antifashiste: Kahreman Yllin, Mestan Ujanikun, Gjin Markun, Zylyftar Veleshnjën, Ramiz Aranitanin. Iu krijuan mbresa pozitive prej tyre. Kahreman Ylli iu duk njeri jashtëzakonisht i kulturuar, Mestani vërtet i pashkollë, por mjaft të drejtë. Gjin Markun e vlerësonte si inteligjent, kurse Ramiz Aranitanin si shumë trim dhe të ndershëm.

NË VJENË I LUFTOI BOLSHEVIKËT

Të gjithë këta në atë kohë nuk i përdorin shpesh termat ideologjike "komunistë" dhe "komunizëm", edhe pse të linin përshlyen se besonin në atë kauzë dhe po të ngadhënjenin në luftën çlirimtare, në Shqipëri do të qenë dakord të vendosej sistemi shoqëror i Bashkimit Sovjetik. Ndërkaq Hasan Alizoti në rininë e tij e pati luftuar me armë bolshevizmin. Kjo kishte ndodhur në Vjenë, menjëherë pas triumfit të revolucionit proletar dhe marrjes nga kryengritësit rusë të Pallatit të Dimrit në Shën Petersburg.

Në 1914 i ati i pati siguruar Hasanit një bursë në Vjenë për të studiuar në një shkollë ushtarake. Atje e zuri edhe Lufta e Parë Botërore me situatën kaotike që ajo solli. Në 1917-1918 u shtri nëpër Evropë dallja e revolucionit rus. Pasi "të kuqtë" morën Budapestin, pra një pjesë të perandorisë austro-hungareze, kjo dallë erdhi edhe në Vjenë. Një pjesë e vendasve u ngritën të rrezonin Habsburgët dhe për të mbrojtur pallatin e tij nga revolucionarët bolshevikë i nxorën të gjithë studentët ushtarakë të armatosur, përfshi edhe bursistët shqiptarë, të cilët ato çaste qenë dhjetë vetë me kuqdestar një major austriak. Pas goditjes me armë kryengritësit u tërhoqën dhe Vjena nuk u bë një Shën Petersburgi i dytë.

Jeta e Alizotëve, edhe pse nuk qenë aspak pronarë tokash apo pasurish të tjera private, por përherë nëpunës administrate shtetërore (edhe i ati i Fejzuit kishte punuar e më pas vdekur si nënprefekt në Novi Pazar), ishte mosapajtuere me çfarë flitej atë kohë për Marks dhe Leninin. Fejziu kishte shërbyer në Turqi, ku edhe qe shkolluar. Nëntori i Pavarësisë 1912 e zuri këtu, në Selanik ku pak më vonë do të ishte i transferuar, bashkë me familjen. Ataturqit e paguanin, por e shihnin me dyshim, madje e konsideronin tradhtar të mundshëm të Perandorisë. Në 1913 u kthye në Vlorë, duke iu përgjigjur rresës së Ismail Qemalit. Kur mbaroi Lufta e Parë botërore, në 1918, i përfundoi studimet ushtarake edhe Hasani. U kthye edhe ai në atë dhe detyrimisht do të hynte në punë, sepse ndryshe nuk jetonte dot. Fillimisht shërbeu si doganier në një pikë më në veri të Morinës, e cila lidhej me Kosovën. Më pas u transferua në Ministrinë e Financave dhe në këtë dikaster qeveritar mbërriti deri 1927, të ministri Kol Thaçi. Më vonë, viti 1927, do të emërohej sekretar i dytë në Legatën Shqiptare në Athinë.

Në vijim u emërua prefekt në Ballsh, qytetë ku zuri miqësi të madhe me të atin e Liri Belishovës, ndërsa kjo e fundit qe fëmijë në vitet e para të shkollës fillore. Në familjen e Abaz Alizotit edhe sot ruhet një foto e nxënësve të vegjël të Ballshit. Pas këtij



Hasan Alizoti, Hiqmet Hasani, Motre Pertef, Venecia 1943



Fejzi Alizoti me të birin Hasanin, Stamboll 1907

qyteti Hasan i transferua nënprefekt në Libohovë, më tej nënprefekt në Zërqan. Pastaj hyri Italia. Pushteti i ri fashist e mbajti ca kohë pezull, por dalloj shpejt se kishte të bënte me një nëpunës të lindur për punë administrimi shtetëror dhe i ofroi qytetin e Beratit.

NË VEPRIM KOLABORACIONIST MERCENARËT E HALIL ALISË

Në skaj të vitit 1942 italianët e pikasën që në luftën e tyre ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Berat diçka nuk shkente. U shkoi në mendje edhe mundësia e një dopiole të prefektit. Ndërkaq në Vlorë gjendja u dukej edhe më e dalë prej duarve të tyre. Prefekti i këtij qyteti, Lele Koçi, i përkushtohet më shumë se Hasan Alizoti mbështetjes së rezistencës të lidhur me LNÇI. Prandaj dërguan në Vlorë mercenarin Halil Alia, i cili kreu terror mbi qytet, vrau në 2 janar 1943 patriotin e famshëm Qazim Koculi si edhe prefektin Lele Koçi. (Siç dihet i revoluar nga këto vrasje të frymëzuara prej komandës së pushtimit kryeministri Mustafa Kruja dha dorëheqje të menjëhershme).

Ndërkaq njësitë mercenare të fashistëve italianë, pasi përjakën Vlorën dhe rrethinat që mbështetnin Lëvizjen Nacionalçlirimtare, u kthyen qendrës tjetër të rezistencës: Beratit. Sapo hynë në qytet filluan të shtinin në ajër me mitraloz dhe pastaj drejt rrugëve. Në kushitet e këtij terrori që mund të përfundonte si në Vlorë, më të vrarë të tjerë, në mos edhe me jetëshuarjen e tij, një togë italiane të drejtuar nga një toger, i cili kishte për detyrë mbrojtjen e institucioneve, Hasan Alizoti e përdori për të frenuar mercenarët e Halil Alisë. Një autobusidë që këta e kishin në dispozicion, e vuri para prefekturës dhe lajmëroi popullatën që të mos kishte qarkullim njerëzish. Kur vërtet jashtë banesave nuk kishte gjë të gjallë dhe përdhunësit kur panë autobusidë në rralluan të shtënat, në rrugën kryesore u shfaq një siluetë. Ishte Hiqmetja, e shoqja e prefekti. Familja Alizoti e kishte shtëpinë tek banka, pra pothuaj në fillim të rrugës kryesore që të conte pas të paktën treqind metrave deri tek ndërtesa e prefekturës. Bashkëshortja, e alarmuar se mos kryhej edhe në Berat vrasja e qëllimshme e prefektit, tek ece fillikati i ndjeu plumbat që filluan t'i binin fare afër. Ishin vetëm dy mercenarë që e kishin këtë zell. Sapo i pa ku qenë struktur, prapa Hotel Kolombos, u bërtiti: "Po të jeni trima u shtini burrave!" Pas kësaj ata ja mbathën. Një çast më pas në mbrojtje të Hiqmetes vrapuan disa ushtarë italianë.

FEJZI ALIZOTI: NUK DUA TA TAKOJ MILADIN POPOVIÇIN

Kur Popoviçi në pranverë të vitit 1943 iu afrua ilegalisht Beratit, i tha Gjin Markut se donte të takonte Hasan Alizotin. Takimi mes komunistit të rëndësishëm jugosllav me shumë ndikim në PKSH dhe prefektin u krye pa asnjë problem. Nga biseda Alizoti do të dilte me përshtypje të mirë për Pop-

oviçin. Por pas pak kohe i erdhi kërkesa se ky i fundit dëshironte të takonte edhe të atin. Hasan i ktheu përgjigjen se këtë gjë nuk mund t'ia premtonte: "Babai ka qëndrimin e tij, por unë do t'i them".

Kur çfarë kërkonte Miladini ia komunikoi të atit, Fejziu u mendua një çast, por më në fund ra dakord. Takimi do të bëhej në banesën e Hasanit në Berat dhe që të dy, në kohë të ndryshme, në ditën e caktuar u ndodhën aty. Veç qëndruan në dhoma të ndryshme. Kur u duk se gjithçka ishte gati për bisedën dypalëshe, Fejziu papritmas refuzoi: "Unë nuk do ta takoj, sepse po e takova do të merret vesh e çfarë mbetet për mua kur të dalë një gjë e tillë".

7. Pas Beratit Hasan Alizoti do të emërohej prefekt në Shkodër. Pastaj erdhën gjermanët dhe këta, edhe pse e liruan nga detyra, gjithsesi vijuan ta paguanin. E konsideronin kandidatë në rezervë. Kështu nuk kaluan vetëm muajt e fundmotit 1943, por pothuaj tërë vit pasardhës. Në shtator ata që kishin mbështetur pushtuesit për të luftuar komunistët, përfshi edhe qeveritarët, filluan të iknin jashtë vendit. Shefqet Verlaci, më i pasuri në Shqipëri, i shkoi në shtëpi Fejzi Alizotit. "Hajde, mos rri", i tha. I shkoi edhe Safet Libohova, i vëllai i të shoqes së të birit, Hasanit, nënprefekt në Libohovë. Ky i tha troç: "Eja të ikim, mos rri këtu, sepse komunistët të kanë dënuar me vdekje". "Jam plak, nuk kam ku vete", iu përgjigj Fejziu. "Para nuk kam, shtoi, do të rri këtu. Çfarë të më gjejë të më gjejë". Kështu nuk iku ai,



Hasan Alizoti, Akademia Ushtrake Vjenë 1915

por as Hasanin. Ku ta linte vetëm? Derisa filloi Lufta e Tiranës.

Në kryeqytet familja Alizoti shtëpinë e kishte tek ura e madhe mbi Lanë afër Hotel Dajti. Ato kohë aty kanë qenë disa vila, ku pas luftime banuan Myslim Peza dhe Adil Çarçani. Jo e para vilë nga rruga, por e dyta, që strehë e Alizotëve. Në pasditën e 16 nëntorit shtatë gjermanë patën mbetur të izoluar tek cepi i urës, atje ku ishte një barakë me ngjyrë jeshile e ndërtaur prej italianëve. Ata vazhdimisht shtinin mbi partizanët. Prej këtij zjarri të dendur këta nuk guxonin të bënin përpara. Pastaj mbërriti një çast, sapo kish rënë nata, kur gjermanët e lanë barakën, kërcyren rrugën dhe trokitën në derën e banesës së Alizotajve. Kërkuan të mund të strehoheshin për pak kohë, për t'u dorëzuar më vonë partizanëve, veç jo në ato momente të nxehta, sepse kishin për t'i vrarë në vend. Hasanin që i dëgjoi pa u hapur derën, u shpjegoi në gjuhën e tyre se nuk mund ta bënte dot këtë gjë, në shtëpi kishte fëmijë dhe gra, madje që edhe babai i tij shumë plak. Shtatë gjermanët u rikthyen sërisht tek baraka jeshile dhe vazhduan të rezistonin. Mbljetuan deri në mëngjes herët, ora gjashtë, kur më në fund, përballë partizanëve të shtuar numerikisht, u vranë njëri pas tjetrit. Për aq sa shihet qartë nga dritaret e banesës së familjes Alizoti, nacionalçlirimtarët nisën t'i grabitnin pa i lënë radhë njëri-tjetrit. U hiqnin unazat dhe kërcenin ç'të gjenin nëpër xhepa. Pa shkuar ora shtatë e asaj dite, 17 nëntor 1944, jashtë vilës së tyre Alizotët dëgjuan se si fitimtarë e thërrritnin njëri-tjetrin me zë të lartë dhe gëzim "O Rrapo" apo "O Çelo!" Ishte e qartë: e kishin marrë qendrën e Tiranës dhe komanda e tyre pati hyrë dhe vendosur në Hotel Dajti. Atje më i madhi nuk dukej se që Mehmet Shehu, por Dali Ndëru.

Pa u afruar ora nëntë tek porta e vilës erdhi një grup partizanësh dhe thanë se do të bënin një kontroll. Gjetën tri pushkë dhe pyetën se të kujt qenë. Hasanin iu përgjigj se njëra që e truprojtës së tij. "Kush është i pari i shtëpisë?", pyetën ardhësit prerë, pa prituar sqarimin e plotë. Hasanin tregoi të atin. "Epo ky do të vijë me ne", thanë ata. "Ky është plak njëri, ndërhyri Hasanin, do të vij unë me ju". Partizanët e vunë në mes dhe e morën me vete. Ndërsa iknin rrugës lart, drejt qendrës, Hasanin pa gjithkund të vrarë dhe kuaj të ngordhur. Kur iu avitën Kullës së Sahatit dhe Xhamisë, një gjerman i plagosur dhe i shtrirë tek dera e njëres prej godinave, të cilat më pas u bënë ministri të ndryshme, filloi t'i qëllonte me mitraloz. Hasanin i thirri: "Mua më kanë arrestuar, mos qëlllo se do të më vrasësh!" "Ik ti se do t'i vras ato të tjerët!", iu përgjigj gjermani. Atëherë Hasanin u thotë partizanëve: "Jepani vrapit dhe fshihuni pas godinës tjetër!" Këta ia dhanë vrapit vërtetë dhe shpëtuan nga breshëritë e gjermanit të plagosur. Kur mbërritën në Hotel Kontinental, i cili ishte

fare afër dhe deri një ditë më parë pati qenë komandë e gjermanëve, Hasanin e futën në bodrum. Në dhomën nëntokësore, ku i ndrymë, ndodhej edhe një oficer nazist. Ky filloi t'i thoshte me alarm se pas një gjysmë ore hoteli do të hidhej në erë. "E kam minuar vetë unë!" këmbëngulte gjermani. Atëherë Hasanin nisi t'i binte me grusht derës dhe të thërriste dikë për ta dërguar. Më në fund tek dera u shfaq një partizane dhe kjo mezi e kuptoi përse duhej të njoftonte komandantin e saj për ta hapur sa më shpejt derën. Pas kësaj oficeri vrapoi menjëherë tek ekspozivi dhe ndërsa dolën jashtë ndërtesës të gjithë ata që kishin qenë brenda, e çminoi.

Por Hasanin dhe nga dy të tjerë që sapo i kishin arrestuar, për shkak se burgu akoma nuk që marrë nga që bënte rezistencë kokëfortë Osman Gazepi me disa nga të tjerët, i mbyllën tek Pallati i Zogut. Këtu kishte mbiel dhe sheqer dhe ardhësit gjetën mundësi, për t'u ushqyer, të paktën të gatimin hallvë.

Ndërkaq Hasanin nuk e dinte që një orë pasi e patën arrestuar një grup partizanësh kishte rihyrë në shtëpinë e tyre dhe i kishin marrë të atin. Ishte ftohtë dhe plaku shtatëdhjetë e gjashtë vjeçar mori me vete një brucë. Bashkë me të tjerë të porsaarrestuar i vendosën për më shumë se një javë në tarracat e Pallateve Moskate. Natë e ditë me roje ngryesheshin e gdhiheshin, ndërkaq nuk u mor vesh kurrë nëse hanin ndonjë copë bukë. Më në fund ndërtesa e "Burgut të Ri" që marrë dhe i futën të gjithë në birucat e tij. Në një kaush të madh u gjetën pranë njëri-tjetrit, për një rastësi apo qëllim të prapë të pushtetarëve të rinj, baba e bir.

Në fillimpranverë 1945 u organizua Gjyqi Special dhe mes të 17 të dënuarve me pushkatim që edhe Fejzi Alizoti. Pas kësaj dite atë dhe të tjerët i vunë në një qeli përballë birucës së mëparshme. Hasanin më të atin shkëmbejnë mesazhe me copëra të vogla letre, të cilat i futnin nëpër brimat e kyçit të dyerve sa herë që dilnin për të shkuar në banjë. Abazi, i biri i Hasanit, i cili është edhe burimi kryesor i informacionit për këtë shkrim, i ruan ende ato copëra pusullash tronditëse.

Djali tjetër i Fejzuit, Rizai, erdhi që nga Kuçova për ta takuar babanë e vet, priti dy ditë, por nuk e mundësuan. Thuhej se të dënuarit i kishin shvendosur në një banesë afër, shtëpi e tregtarit Ali Qorrailiu, ku u patën dhënë për të ngrënë e sidomos pirë që të ishin të trulllosur. Ditën e tretë të mbërritjes së pafat të Rizait për ta takuar të atin, në 14 prill 1945, të shtatëmbëdhjetë i hipën në kamionë dhe i dërguan tek Kodra e Priftit. Atje i ekzekutuan. Pesëmbëdhjetë prej tyre i zunë plumbat, ndërsa arbëreshi Terenc Toçi pati rënë përdhe pak çaste më parë nga një infarkt zemre. 76-vjeçarin Fejzi Alizoti plumbat e kishin marrë njëri në pëllëmbë të dorës së djathtë dhe tjetri i kish fshikur në grykë, në flikthin e gurmazit. Qe rrethuar dhe ato çaste u dëgjua zëri i tij i dobët, tek i thoshte Bedri Spahiut: "Edhe tui nuk më dënoi me vdekje. E drejta ndërkomëtare e ka që kur një të dënuari i këputet litari apo nuk e zë plumbi, i falet jeta". Por tjetri nxori pistoletën dhe pasi i kërciti fjalët "Nuk ka falje për ty", e qëlloi në kokë.

Kur Hasan Alizoti në fund të prillit, bashkë me nëntë të tjerë, doli në gjyq në sallën e kinemasë në vendin ku sot ndodhet selia e Partisë Socialiste, kryetar gjyqi që Bilbil Klosi dhe prokuror Gjon Banushi. Populli në sallë thërriste pa pushim: "Prefekti fashizmit në litari!" Kur u dhanë dënimet nëntë qenë me pushkatim, kurse kur u shpall ai i Hasanit prokurorri shqiptoi: "Ka qenë prefekti fashizmit dhe bashkëpunëtor i okupatorit, por e shikoj në lidhje të ngushtë me krerët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare". Pas kësaj sala e madhe e kinemasë e mbushur plot filloj të duartrokiste. Tre vjet burg kërkoi Gjon Banushi, dy e bëri Bilbil Klosi. Në 29 nëntor 1945 u njoftua amnistia e parë dhe një ndër ata të ndodhur në fillim të listës ishte Hasan Alizoti. Kështu bëri gjithsej një vit burg.

Pjesa tjetër e jetës së tij janë shpërngulja me forcë nga Tirana për në Durrës dhe më në fund 30 vjet qëndrimi në Lushnjë, me punë në një nga sektorët e fermës, në Savër kryesist. Në 1978 Hasan Alizoti ndërroi jetë, kurse e shoqja, Hiqmetja, në 1985.

Dje në "Deutsche Welle"

Thaçi e Vuçiç në Bruksel - Zgjidhje e afërt Kosovë-Serbi?

Nga Virtyt Gacaferi

(vijon nga faqja 1)

... shprehën edhe qëndrimet e tyre të ndryshme lidhur me mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje në të ardhmen e afërt.

Presidenti i Kosovës tha, se ai mendon që në të ardhmen e afërt mund të arrihet deri te një marrëveshje, një mendim që nuk e ndau edhe presidenti serb Vuçiç, i cili mendon se palët nuk janë afër gjetjes së zgjidhjes.

"Realisht unë shpresoj dhe besoj se marrëveshja mund të arrihet në një të ardhme të afërt. Ky mobilizim i faktorit ndërkombëtar i ShBA-së dhe Bashkimit Evropian është mesazhi më i mirë edhe për ne në Kosovë, se ne duhet të punojmë bashkërisht. Duhet që ky ekip negociator të përgatitet edhe më mirë të krijojë grupet profesionale të komunikojë me qytetarët që të kemi një proces krejt transparent dhe me një përfshirje sa më të gjerë politike", tha Thaçi.

Nga ana e tij Presidenti Vuçiç duke komentuar letrën e Presidentit Trump, ku thuhet se "negociatat janë futur në fazën finale" tha se ai nuk pajtohet me këtë.

"Me këtë unë nuk pajtohem plotësisht dhe nuk mendoj se jemi



afër zgjidhjes, por më duket se kjo (letër) tregon që SHBA-ja është e interesuar që të arrihet deri në një marrëveshje çfarëdo që të jetë ajo. A është kjo e mundur a është reale kjo gjë nuk mendoj se është një çështje e lehtë apo thjeshtë",-tha Vuçiç.

Sa i përket letrës nga Shtëpia e Bardhë Vuçiç shtoi, se ajo flet edhe për dy gjëra të tjera: "E para është se SHBA-ja është e interesuar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës me një kompromis, e dyta se në këtë është përfshirë edhe kreu i SHBA-së në mënyrë të hapur dhe pa mëdy-

shje, që do të thotë se një makineri e madhe do ta mbështesë këtë proces",-tha ai.

Nga ana e tij presidenti Thaçi për letrën e presidentit të SHBA-së tha, se ajo është "shpresë dhe besim për institucionet e vendit. Letra është zëri i Amerikës është

mbështetja e plotë unike për Kosovën dhe rajonin. Nëse dikush ka pasur hezitime deri tani për rolin SHBA-së, kjo tregon dhe dëshmon qartë se SHBA është e involvuar në procesin e mbështetjes së plotë të arritjes së një marrëveshjeje Kosovë-Serbi".

Vazhdimi i negociatave

Presidenti Thaçi tha se në këtë vit nuk pret fillim të negociatave, pasi tashmë kanë filluar festat, por ato mund të fillojnë në vitin e ardhshëm. Ndërsa sa i përket tarifës prej 100 për qind ai tha se gjatë drekës janë diskutuar shumë gjëra rajonale, pra edhe këto probleme.

Nga ana e tij Presidenti Vuçiç tha, se ata janë të gatshëm të vazhdojnë negociatat, por jo pa u hequr tarifa. "Me rëndësi është se ne nuk kemi ndryshuar qëndrim", theksoi ai, duke shtuar, se kjo është një gjë shumë e rëndësishme dhe se nuk do të ketë vazhdim dialogu pa heqjen e tarifave doganore.

Përkundër këtij kushti, Vuçiç theksoi se dialogu nuk ka alternativë dhe se duhet të gjendet një zgjidhje. "Por ne nuk kemi alternativë, veçse të diskutojmë dhe të gjejmë zgjidhje. Nëse nuk gjejmë një zgjidhje të mirë mundet që një zgjidhje e keqe të na gjejë neve dhe të na kthejë 50 apo 100 vite prapa",- nënvizoi ai.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion *i* Ditës

Luli dhe Monika si freshistë të devotshëm

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... fund bojkotit të Kuvendit duke iu kthyer atij në sallë.

Dhe e bukura nuk përfundon këtu. Kulmi i ironisë është se ata pretendojnë se këtë "sakrificë" po e bëjnë për studentët.

Në fakt, protestuesit e dinë shumë mirë se çfarë duan.

Të martën, një vajzë në Universitetin Bujqësor e nxori bllof shown e përgatitur gjoja për dialog me Ramën. Në Vlorë, skena u përsërit në përmasa shumë më të mëdha. Studentët që ishin lënë jashtë, hynë në sallë vetëm për t'i thënë kryeministrit se nuk kanë nevojë të dëgjojnë monologët e tij nga 3-4 orë në ditë. Ata e etiketuan atë si të padenjë për bashkëbisedim deri sa nuk plotësonin kërkesat më minimale.

Ata u larguan demonstrativisht, duke lënë pas imazhin e një Rame, çehrja e të cilit ngjante si në ditët e veta më të këqija.

Por ajo që po përvijohet nga bashkëbisedimi i Ramës me ata pak studentë të denjë që qëndrojnë në sallë, është edhe më e rëndë.

Ata po japin raste të një varfërie therëse. Ata po tregojnë shembuj të prindërve të tyre, që jo vetëm nuk kanë mundësi të paguajnë për shkollim, por që nuk kanë shans as të kurohen apo të zgjidhin hallat me këtë administratë. Ata po vënë theksin tek një padrejtësi që u heq çdo mundësi për të ardhmen.

Ata janë të ndërgjegjshëm se të gjitha këto janë në konflikt me realitetin virtual që do të krijojë kryeministri.

Prandaj, njëzëri ata bien dakord se me Edi Ramën dialogu është aq i kotë sa edhe i pamundur.

Po t'i shikosh bataretë verbale të opozitës, ato janë ku e ku më të rënda. Ajo, përpos shkatërrimit të arsimit, luksit që buron nga vjedhja, e akuzon kryeministrin edhe



për lidhje me krimin, për drogën, për grabitjen e zgjedhjeve, për njëmijë e një mëkate të tjera.

Dhe kur bën këtë krahasim, në mendje të vjen një pyetje naive: Po pse të parët që ende nuk e kanë shpallur armik, i dalin Ramës nga salla, ndërsa të dytët e ndjekin si qengja nga pas?

Përgjigjja është e thjeshtë. Studentët janë të pastër, të çiltër, të pakalkular në zemërimin dhe mllëfin e tyre. Ata nuk janë bërë ende pjesë e një sistemi që të ul kokën, prandaj sillen ashtu.

Ndërsa PD dhe LSI, e kanë hal-

lin tek mandatet, tek pushteti i të qenit opozitë, tek përfitimet monetare që burojnë prej tij, tek anktin i të lënit të skenës bosh, tek gjera banale si rroga, dietat, pagesa e celularëve dhe karburanti.

Të qenit deputetë ata e shohin si status, si pjesë e kastës, si mundësi për të rikapur karrigen e kundërshtarit dhe aspekt si ide apo si mision.

Prandaj ata po kthehen kokulur në parlament duke bërë rolin e atyre freshistave, me të cilët Rama po mbush sallat duke i paragjitur si kundërshtarë falso.

Me rikthimin në parlament, edhe Luli edhe Monika, po kryejnë aktin suprem të një opozitë false. Le ta bëjnë, ndoshta është e kotë t'u kërkojmë shumë. Ndoshta është e tepërt të pretendosh të dalin nga guaska ku janë mësuar.

Le të hyjnë.

Por të paktën të na kursejnë në të tjerëve skenat heroike se po sakrifkohen për studentët.

Le të futen me kokën ulur dhe sytë përmbys, duke mos u tallur me ata që po e refuzojnë me këmbëgjulje bashkëbisedimin me Ramën.

HOROSKOPI

DASHI

Detyra kryesore për sot do të jetë të bëni një plan për fundjavën. Ka shanse të mërrni një ftesë për në një event të rëndësishëm. Në mbrëmje mund të debatoni me një nga familjarët ose me partnerin/partneren.

DEMI

Disa persona të kësaj shenje nuk do të mund të përfundojnë projektet që kanë nisur. Lidhur me këtë do të ndodhë edhe disa rrethana të caktuara. Kjo do t'ju tensionojë paksa, megjithatë mos u shqetësoni, pasi gjithçka do të kalojë.

BINJAKET

Disa Binjakë do të trishtohen, pasi ajo çfarë presin nuk do të ndodhë. Duhet të dini nga ajo gjendje, në mënyrë që të ecni përpara dhe të keni sukses si në çështjet personale, ashtu edhe profesionale.

GAFORJA

Gaforet mund të bëhen supersticioze sot. Ka gjasa që njëri pranë jush mund të bëjë një veprim që nuk do t'ju pëlqejë aspak. Koha vetë do t'i vendosë gjërat në vendin e duhur. Përkushtojini disa detajeve që do t'ju ndihmojnë në gjetjen e pages.

LUANI

Luanët sot do të përjetojnë emocione të forta. Madje, do të shkaktohet një situatë që do t'ju prejë direkt, çfarë nuk do t'ju pëlqejë aspak. Përpunoni që të mos pushoheni nga paniku, pasi mund të bëni hapa të gabuar.

VIRGJERESHA

Do të gjendeni në një dilemë në sferën e dashurisë. Mund të vihen në dyshim për të nisur një marrëdhënie të re dashurie. Ndërsa çiftet e martuara do të përballen me konflikte të mëdha, të cilat mund të çojnë edhe në divorc.

PESHORJA

Mos bëni premtime, të cilat nuk i mbani dot. Para se t'ju pyesë dikush për një çështje të caktuar, fillimisht mendoni në mënyrë objektive, pasi do iu duhet ta fusni veten shumë në rrezik për ta realizuar atë. Bëni kujdes në mbrëmje pasi mund të përfshihen në një incident.

AKREPI

Do të jeni shumë produktiv gjatë ditës. Do të përfundoni një detyrë të cilën e kishit lënë përgjysmë. Ka gjasa që komunikimi me një person të rëndësishëm të marrë një rrethë pozitive. Në shtëpi mund të përballeni me probleme.

SHIGJETARI

Përgatitni për sukses në një çështje biznesi. Mund të vlerësoheni me çmim në punë dhe të ardhurat tuaja financiare do të jenë të mira. Mos bëni plane për udhëtime të gjata. Do të ishte mirë ta kaloni mbrëmjen në shtëpi pranë familjarëve tuaj.

BRICJAPI

Disa probleme të vogla në dukje mund të bëhen shkak për disa probleme të mëdha. Ato do të vijnë si rezultat i mungesës së vëmendjes suaj për disa çështje të caktuara. Përpunoni të veprojnë në kohën e duhur, në mënyrë që të parandaloni atë çfarë mund të ndodhë.

UJORI

Disa Ujorë do ta kalojnë ditën duke ndjekur kreativitetin e tyre. Ka gjasa të arriren rezultate të mira në punë, por gjithsesi nuk do të ndihen plotësisht të kënaqur. Gjatë ditës së sotme mund të mendoni rreth planit për Krishtlindjet.

PESHQIT

Peshqit nuk do të kenë asgjë për të mbajtur mend në fund të ditës. Nuk do të kaloni një ditë ashtu sikurse e prisnit. Mos u largoni nga realiteti. Do të ishte mirë të dëgjoni këshillën e miqve.

PRESIDENTI BARDHEBLU

Presidenti i Tiranës, Refik Halili, ka bërë një deklaratë të fortë tek sa flet në "Supersport", gjatë mbremjes gala të organizuar nga FSHF. Halili shprehet se viti i ri do të sjellë ndryshime të mëdha tek Tirana, ku priten edhe donatorë të



rinj. "Ky nuk ka qenë një vit i mirë. Uroj që të ndryshojmë në të ardhmen. Uroj që ky të jetë viti i fundit me këto rezultate dhe në të ardhmen të ecim përpara. Nuk është se ka gabuar një futbollist, por herë njëri dhe herë tjetri. Dua të përmbledh me pak fjalë. Qofshin të gjitha të këqijat me këtë vit dhe të ikin. Përfitoj nga rasti të uroj tifozët e Tiranës gë-

Halili: Pres donatorë të rinj tek Tirana

zuar vitin e ri dhe them se viti i ardhshëm do të jetë më i mirë, pasi do të ketë shumë ndryshime sa i përket aksionarëve të rinj. Duhet të bëjmë një sqarim të qartë. Shpresoj që këtë vit të ketë shumë ndryshime. Partnerët nuk i afrojnë, por vijnë vetë. Do ketë

donator të ardhshëm dhe them se do të jenë nga njerëzit e biznesit më të mëdhenj në Shqipëri. Do flasim me njerëzit të cilët janë të interesuar nga biznesi dhe e njohin sportin. Nga fillimi i vitit do kemi një përgjigje të saktë. Merkato? Në janar është

të e vështirë të gjej lojtar, dhe këmbëngul se ne kemi lojtarë të mirë. Ndoshta do të duhet pak punë dhe kurajë qoftë nga staffi dhe drejtuesit, por edhe drejtori sportiv që me pak ndryshime skuadra do të ecë para. E sigurt që do të kemi pak merkato dhe uroj të na dalë fat që të marrim 2-3 lojtarë sa më të mirë", - deklaroi Halili.

Jeton Selimi



Presidenti Duka shfaqet në humor. Batuta me të gjithë të ftuarit. Megi Doçi shpallet lojtarja më e mirë

Trashë futbollisti më i mirë Jorgji lë pas gjyqtarët e tjerë
Mbrëmja gala e FSHF-së, nderohen legjendat



me Edvin Muratin, Klodian Duron dhe Elvin Beqirin, të katërt pjesë e suksesit historik ndaj Greqisë, 2-1 në 4 shtator 2004. Në mbremjen e organizuar nga FSHF, janë shpërndarë edhe disa çmime për legjendat e futbollit shqiptar, por edhe për më të mirët e se-

zonit që lamë pas. Ndërkohë, futbollisti më i mirë i vitit është shpallur Lorenc Trashi, ndërsa në futbollin e femrave, Megi Doçi është shpallur futbollistja më e mirë. Nuk ka dyshime për arbitrin më të mirë, dhe ai që zgjidhet është Enea Jorgji. Në një prononcim për

Supersport pasi u shpall Lojtari më i Mirë i vitit 2018, është mbrojtësi i Partizanit, Lorenc Trashi, i cili shprehet i surprizuar për këtë çmim. "Meqë mora këtë trofe, dua ta mbyll edhe me një tjetër, duke fituar kampionatin. Këtë vit kampionati është shumë i fortë, dhe titullin e

ÇMIMET
NDERI I FUTBOLLIT SHQIPTAR

- Perlat Musta
- Edvin Murati
- Qamil Teliti
- Genc Tomori
- Osman Memaj
- Agim Canaj

FUTBOLLISTI MË I MIRË

- Lorenc Trashi

FUTBOLLISTJA MË E MIRË

- Megi Doçi

GJYQTARI MË I MIRË

- Enea Jorgji

fiton skuadra që do bëjë më pak gabime. Këtë çmim nuk e prisja, u surprizova. Ndihem shumë i vlerësuar. Ky është viti im i pestë te Partizani, dhe çdo vit është folur për një transferim të mundshëm jashtë, por nuk është bërë asgjë. Këtë gjë e ka në dorë presidenti, unë do vazhdoj të jap maksimumin për Partizanin." - deklaroi Trashi.

TRAJNERI KËRKON QETËSI

Murinj: Mirënjohës Mançesterit, por është kapitull i mbyllur
Mançester Junajtid shkarkoi Zhoze Murinjon ditën e martë, duke ndërprerë bashkëpunimin me një nga trajnerët më influencialë në botën e futbollit. Gazetarët e "SkySport" kanë arritur t'i marrin një intervistë teknikut portugez, i cili nuk ngurroi të flasë pas shkarkimit: "Jam shumë mirënjohës që kam qenë trajner i Mançesterit. Unë besoj se të gjithë tifozët e Junajtid e dinë këtë. Ashtu si në të kaluarën time, kam punuar me shumë njerëz të mëdhenj dhe unë besoj se disa prej tyre do të mbeten miqtë e mi për pjesën tjetër të jetës. Gjithkush i njeh parimet e mia të punës. Çdo herë që mbyllet një kapitull, tregoj respektin maksimal ndaj kolegëve të mi. Shpresoj që mediat të respektojnë pozicionin tim dhe do të më lejojnë të jetoj një jetë të qetë derisa të rikthehem", - u shpreh portugezi.

Tri mungesa të rëndësishme për korçarët

Skënderbeu po vuan shumë për rezultate javët e fundit, e madje gaboi edhe në shtëpi me një kundërshtar modest si Luftëtari i Gjirokastrës. Korçarët e nisën garën me pretendime, por me rezultatet e javëve të fundit po rrezikojnë edhe një vend në Kupat e Evropës. Ndeshja me Luftëtarin duket se i kushtoi shumë Dejvi Bregut që shënoi një gol mjaft të bukur, por u ndëshkua me kartonin e katërt të verdhë. Bregu nuk do të jetë në Kamzë, ndërsa skuadra korçar me shumë gjasa s'do të ketë

Shehi me dhimbje koke, edhe Bregu humbet Kamzën



shërbimet e sulmuesit Krasniqi që muajin e fundit ka pasur vazhdimisht oshilacione. Po ashtu edhe Ardit Hoxhaj, që edhe pse është bashkuar dje me grupin nuk do të luajë në kryeqytet. Shqetësuese paraqitet gjendja edhe për mesfushorin Deme, megjithatë, trajneri i bardhekuqe shpreson që ta ketë mesfushorin nga Etiopia në fundjavë.

Verilindorët ndryshojnë sërish stadiumin

Kukësi rikthehet në "Elbasan Arena"



me vetëm 10 pikë. Por, ajo që ka rënë në sy ka qenë se vendi ku do të luhet ndeshja e Kategorisë Superiore, është ndryshuar tashmë. Fillimisht, mendohet se takimi do të zhvillohet në stadiumin e Kamzës, por në fund është zbuluar që do të luhet në "Elbasan Arena, më 23 dhjetor, të dielën në orën 13:30.



MAK ALBANIA HOTEL

31 Dhjetor 2018

20:30



PJESË E
KASTRATI GROUP



MAK ALBANIA HOTEL

Nata e ndërrimit të viteve!

- ~ Menu me 7 raunde dhe pije të përfshira
- ~ Muzikë dhe Argëtim Live nga këngëtarët Altin Goci, Marsela Çibukaj, grupi Ali Pashe Tepelena dhe cirku i Tiranës
- ~ Gëzuar Vitin e Ri me "Moët Chandon" dhe fishekzjarre në tarracën e Infinity Bar
- ~ Shorte me dhurata



**Për prenotime deri me datë 20 Dhjetor, për cdo 6 persona i 7-i falas
Ofertë speciale akomodimi për muajin Dhjetor 75 euro çifti**

Terma dhe kushte

Menu speciale për fëmijë me 50% zbritje për moshën 5-12 vjeç
Fëmijët 0-5 vjeç falas
Parkim i garantuar pa pagesë



+355 4 2274 707



+355 69 20 25205



sales.tirana@makalbania.com

